

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË TIRANË 2024

PËRGATITUR NGA:

**QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM" (GADC)
RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE**

Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia Tiranë

Përgatiti: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Korrik 2024

Tabela e Përmbajtjes

1.	LISTA E SHKURTIMEVE	3
2.	HYRJE.....	4
3.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT	6
	GJETJET KRYESORE	6
4.	METODOLOGJIA E STUDIMIT	10
5.	KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR	12
6.	PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË TIRANË:	13
7.	HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË TIRANË	16
8.	VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK	18
	8.1 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME STAF TË BASHKISË TIRANË:	23
	8.2 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME KËSHILLIN BASHKIAK TIRANË:	25
9.	PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT DHE QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK	29
	9.1 INTERVISTAT E THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT	29
	9.2 PERCEPTIMI QYTETAR (PYETËSORI ONLINE).....	32
10.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	37
11.	REFERENCA (LISTA E BURIMEVE TË PËRDORURA PËR STUDIMIN)	39
12.	ANEKSE	40
	ANEKSI 1. KËRKESA ZYRTARE DREJTUAR BASHKISË TIRANË.....	41
	ANEKSI 2. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME STAFIN E BASHKISË	43
	ANEKSI 3. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME KËSHILLIN BASHKIAK.....	49
	ANEKSI 4. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT.....	55
	ANEKSI 5. PYETËSORI PËR QYTETARËT ONLINE	59

1. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxheti me Pjesëmarrje
GADC	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohej gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën dhe krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interesit dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik” zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”¹ (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatave anëtare të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikën dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën maj – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara² për periudhën shtator 2023 – maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të ligjit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij. Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popNetwork.al/>

² Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç janë Prefekturat, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;• Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;• Qendra Rinore Vlorë,• Epoka e Re, Fier; | <ul style="list-style-type: none">• Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;• Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;• Qendra Rinore për Progres, Kukës,• Gruaja në Zhvillim, Korçë;• Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;• Tjetër Vizion, Elbasan |
|---|--|

3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Në Tiranë, studimi është përgatitur nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”³ (GADC), organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësi në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Tiranë” vlerësoi situatën e realizimit të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjësave publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NjVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik⁴ duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Gjetjet Kryesore

I. Përgjigjet e kërkesës për informim nga bashkia dhe verifikimi i tyre:

- **Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik:** Bashkia Tiranë ka emëruar Z. Dorian Rexhepi si Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Detajet janë të publikuara në faqen e internetit të bashkisë dhe janë verifikuar përmes emailit.
- **Regjistri Elektronik i Projektakteve:** Bashkia Tiranë ka një regjistër elektronik online për projektaktet dhe njoftimet për konsultim. Ky regjistër është i aksesueshëm në faqen e internetit të bashkisë.
- **Plani Vjetor i Vendimmarrjes:** Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes është i publikuar në programin e transparencës, por nuk ka një kopje të ngarkuar për periudhën 2023-2024; vetëm Plani Strategjik është në dispozicion.

³ Faqe zyrtare e GADC: <https://gadc.org.al/>

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

- **Mënyrat e Njoftimit gjatë Konsultimit Publik:** Bashkia përdor regjistrin elektronik për njoftimin e projektakteve. Ndër format e tjera të njoftimit janë postë elektronike, lajmërimi publike, apo ato individuale. Praktika tregon se njoftimet gjithmonë publikohen në regjistrin elektronik.
- **Mënyrat e Marrjes së Komenteve dhe Rekomandimeve:** Komentet merren kryesisht përmes postës elektronike dhe formave verbale të regjistruara në procesverbalet e takimeve publike.
- **Zgjatja ose Përsëritja e Fazës së Konsultimit:** Nuk ka pasur raste të zgjatjes apo përsëritjes së fazës së konsultimit gjatë periudhës së monitorimit.
- **Kopje të Njoftimeve për Takime Publike:** Njoftimet për dëgjesat publike janë të unifikuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të bashkisë.
- **Kopje të Procesverbaleve të Takimeve Publike:** Procesverbalet e takimeve publike për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024 nuk janë publikuar në faqen e internetit të bashkisë.
- **Kopje të Projektakteve të Miratuara dhe Përmbledhje e Rekomandimeve:** Nuk ka një përgjigje të saktë për këtë kërkesë nga bashkia. Raportet për projektaktet janë të disponueshme, por nuk ofrojnë përmbledhje të rekomandimeve të pranuar ose arsyeve për mospranimin e disa rekomandimeve.
- **Raporti Vjetor për Transparencën në Vendimarrje për Vitin 2023:** Bashkia Tiranë nuk ka publikuar një raport vjetor mbi transparencën për vitin 2023. Vetëm rezultatet e sondazheve janë të disponueshme.

II. Gjetjet kryesore nga intervistat e realizuara pranë bashkisë Tiranë

- **Standardizimi i Procedurave:** Të gjithë të intervistuarit konfirmuan ekzistencën e procedurave të standardizuara për njoftimin dhe konsultimin publik, duke përfshirë urdhrat e brendshëm dhe forma standarde të dokumentimit.
- **Mekanizmat e Konsultimit të Publikut:** Dëgjesat publike për PPV, plane veprimi dhe buxhetimi me pjesëmarrje janë konsideruar mekanizma efektivë për konsultimin e publikut.
- **Iniciatorët e Konsultimit Publik:** Kryesisht janë iniciuar nga Kryetari i Bashkisë ose kërkesa nga Këshilli Bashkiak për dëgjesa me karakter social dhe raste specifike.
- **Programi i Transparencës:** Bashkia e Tiranës ka hartuar një program transparence për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut, si dhe ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.
- **Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik:** Emëruar më 5 korrik 2022, i cili është përgjegjës për administrimin dhe koordinimin e njoftimit dhe konsultimit publik.
- **Format e Njoftimit dhe Përfshirjes:** Bashkia përdor regjistrin elektronik, postë elektronike, lajmërimi publike, media audiovizive për konsultimet publike. Njoftimi mund të bëhet dhe përmes formave verbale nga administratorët e lagjeve.

- **Marrja e Komenteve dhe Rekomandimeve:** Komentet merren gjatë dëgjësive publike dhe regjistrohen në procesverbal, gjithashtu priten dhe përmes postës elektronike.
- **Procedurat e Miratuara:** Procesi i njoftimit dhe konsultimit publik është i organizuar sipas Urdhrit të Kryetarit nr. 33338 datë 22.09.2022 për Procedurat Standarde të Veprimit.
- **Mënyrat e Pjesëmarrjes:** Pjesëmarrja qytetare realizohet përmes faqes zyrtare të bashkisë, regjistrit elektronik, sondazheve në njësitë administrative, anketimeve online dhe telefonike.
- **Sfida dhe Vështirësi:** Mungesa e interesit të publikut për të dhënë komente dhe rekomandime; Interesi për informacion është rritur, por shkalla e përfshirjes së qytetarëve në procese vendimmarrëse mbetet e ulët.

III. Gjetjet kryesore nga intervistat e realizuara pranë Këshillit Bashkiak Tiranë

- **Perceptimi i Pjesëmarrjes Publike:** Pjesëmarrja publike është vlerësuar si shumë e rëndësishme për transparencë dhe përgjegjshmëri në qeverisjen lokale. Proceset vendimmarrëse që përfshijnë qytetarët perceptohen si më të legjitime dhe të drejta.
- **Kuadri Ligjor:** Të gjithë të anketuarit e kanë vlerësuar kuadrin ligjor për angazhimin dhe konsultimin publik si të qartë dhe të plotë.
- **Procedurat dhe Rregulloret:** Përveç kuadrit ligjor, Rregullorja e Këshillit Bashkiak (Nr. 22, 19.04.2023) përcakton udhëzime dhe procedura për njoftimin dhe konsultimin publik, duke ofruar qasje të lehtë në informacion.
- **Bashkëpunimi:** Ekziston një bashkëpunim pozitiv midis Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për realizimin e procesit të konsultimit publik.
- **Mjetet e Informimit:** Këshilli përdor një gamë mjetesh për të informuar qytetarët dhe grupet e interesit, përfshirë regjistrin elektronik, postën elektronike, lajmërimin publik, dhe mediat sociale.
- **Monitorimi dhe Raportimi:** Ka një mekanizëm të dedikuar për monitorimin dhe raportimin e procesit të konsultimit publik.
- **Miratimi dhe Zbatimi i Projekt Akteve:** Rekomandimet dhe projekt aktet e konsultimeve mund të përfshihen në buxhetin e propozuar ose të diskutohen si pika të veçanta në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Këshilli monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e vendimeve të miratuara në përputhje me njoftimin dhe konsultimin publik.
- **Pjesëmarrja dhe Konsultimi Publik:** Aktivitetet e përfshira në konsultime përfshijnë buxhetimin me pjesëmarrje, seanca dëgjimore, publikimin e informacionit online dhe përdorimin e mediave sociale. Matja e kënaqësisë së qytetarëve dhe përdorimi i metodave të ndryshme për të marrë reagime janë praktikë e vazhdueshme.
- **Sfidat dhe Nevojat për Përmirësim:** Një sfidë kryesore është hartimi i një rregulloreje të veçantë për konsultimin publik. Nevojitet asistencë nga ekspertë të huaj dhe vendas për të përmirësuar proceset dhe për të adaptuar praktikat më të mira evropiane.

IV. Gjetjet kryesore nga intervistat me grupet e interesit:

- **Njohja dhe Shfrytëzimi i të Drejtave për konsultimin publik:** 90% e të intervistuarve e njohin të drejtën e pjesëmarrjes dhe e shfrytëzojnë për bashkëpunim me administratën e bashkisë dhe Këshillin Bashkiak.
- **Mjetet e Njoftimit:** Njoftime Individuale (Më të zakonshmet); Përmes Administratorit/Kryeplakut; E-mail dhe Mediat Sociale.
- **Problematikë:** Njoftimet shpesh ndahen në grupe të mbyllura, që nuk mbulojnë të gjithë qytetarët në kohë.
- **Proceset e Pjesëmarrjes:** Dëgjesa për projekt-buxhetin 2024, plane sociale, strategjinë për Barazinë Gjinore; Pjesëmarrje ndonjëherë në konsultime për miratimin e planeve vendore dhe dëgjesa publike për buxhetimin me pjesëmarrje.
- **Rekomandimet dhe Bashkëpunimi:** Rekomandimet shpesh dërgohen me email ose në zyrën e protokollit të bashkisë. Mënyra e komunikimit dhe reagimi ndaj rekomandimeve është e kufizuar; shumë rekomandime nuk reflektohen në dokumentet finale.
- **Bashkëpunimi me Bashkinë:** a). Biznesi Lokal: Raportojnë bashkëpunime me pushtetin vendor; b). Qytetarë Aktivë: Bashkëpunime në periudhën e konsultimeve për buxhetimin me pjesëmarrje. c). OSHC: Ndonjëherë bashkëpunime të kufizuara.
- **Përvoja dhe Perceptimet për Procesin e Konsultimit Publik:** Informacioni mbi arsyet dhe ndikimet e projekt-aktit është dhënë. Mungon informacioni i plotë si dhe periudha e dorëzimit të rekomandimeve është shpesh e shkurtër.
- **Perceptimi për Pjesëmarrjen:** Proceset e konsultimit shpesh bëhen për të përmbushur procedurat ligjore dhe nuk nxisin diskutime të thella dhe ndryshime reale. Mungesa e besimit në autoritetet dhe në efektivitetin e konsultimeve publike.
- **Sfidat në Zbatimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik:** a). **Mungesa e Informacionit:** Gratë dhe vajzat në zonat rurale janë të përjashtuara nga informacioni; Mungesa e formave të ndryshme të njoftimeve dhe strukturës për përfshirjen efektive. b). **Përfshirja në Dëgjesat Publike:** Aktivizimi i qytetarëve është i kufizuar për shkak të periudhave të shkurtra për pjesëmarrje dhe mungesë të transparencës në mbledhjet e Këshillit Bashkiak; Mungesa e infrastrukturës dhe njoftime të kufizuara për grupet e interesit.
- **Rritja e Aktivizimit të Qytetarëve:** Disa besojnë se aktivizimi do të rritet me më shumë informacion dhe reflektim të nevojave në dokumente. Të tjerë nuk kanë vënë re ndryshime dhe besojnë se proceset janë formale dhe të ndikueshme nga axhendat politike.

V. Gjetjet kryesore nga përgjigjet e qytetarëve në pyetësorin online:

- **Numri i pyetësorëve të plotësuar:** 136
- **Gjinia:** 64% Femra, 34% Mashkull
- **Zona e banuar:** 94% Urbane, 6% Rurale

- **Grupmosha e pjesëmarrësve:** 30-45 vjeç: Kryesisht aktivë dhe të angazhuar; 15-29 vjeç: Aktivë në përdorimin e rrjeteve sociale; 46-65 vjeç: Të interesuar në çështje publike; Më të vjetër: Angazhimi bie ndjeshëm
- **Njohuritë mbi Ligjin për Konsultimin Publik:** 50% janë të informuar
- **Ndarja Gjinore dhe Aktivizmi:** a). Gratë: 70% të të informuarve b). Meshkuj: 30% të të informuarve.
- **Pjesëmarrja në Dëgjesat Publike:** Pjesëmarrës në dëgjesa: 17.6%; Grupmosha e angazhuar: 30-45 vjeç.
- **Arsye për mungesë pjesëmarrjeje:** Mungesa e informacionit (38.3%); Pasiguri në ndikimin e mendimeve (18.1%); Mungesa e interesit (16.8%); Problematika personale (16.3%).
- **Mënyrat e Informimit për Dëgjesat Publike:** Lajmërimi Individuale; Administrata Lokale/Kryeplaku; Mediat Sociale dhe Email; Nuk raportohet pjesëmarrje nëpërmjet faqeve web ose regjistrin elektronik
- **Vërejtjet dhe Sugjerimet në Dëgjesat Publike:** 7 persona ishin të sigurtë se iu ishin marrë parasysh në mënyrë të plotë; 2 pjesërisht në konsideratë; 4 persona të bindur që nuk iu ishin marrë në konsideratë sugjerimet e tyre dhe 13 nuk ishin të sigurtë.
- **Ankesat dhe Përgjigjet ndaj Ankesave:** 3.7% kanë bërë ankesa dhe kanë marrë përgjigje; 8.8% kanë bërë ankesa dhe nuk kanë marrë përgjigje; 87.5% nuk janë ankuar.
- **Përmirësimi i Vendimmarrjes përmes Procedurave të Konsultimit Publik:** 67% besojnë në përmirësim dhe 32% të tjerë nuk pajtohen me këtë qëndrim.
- **Problematikat në Konsultimin Publik:** Mungesa e njoftimeve në kohë; Konsultime publike formale si formalitete; Përjashtimi i grupeve të interesit; Mungesa e mundësive për të shprehur mendime alternative; Mungesa e materialeve shoqëruese dhe diskutuese; Mosmarrja parasysh e rekomandimeve; Mungesa e interesit të qytetarëve.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014⁵) në bashkinë Tiranë, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjeteve dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik” realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.⁶
- Rishikimin e dokumenteve strategjike, publikimeve në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimeve në programin e transparencës, raporteve të prodhuara dhe

⁵ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

⁶ Raporti për bashkinë Tiranë nga GADC 2022: <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-tirane/>

bazave të të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;

- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmeve të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.
- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të bashkisë, për dijeni Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.
- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit dhe trajnimin e intervistuesve;
- Intervista të thëlluara me stafin e bashkisë
- Intervista të thëlluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak.
- 30 (18F/12M) intervista të thëlluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (16 intervista me OJF, Biznese, aktivistë të shoqërisë civile dhe 14 të tjera me qytetarë nga grupet e interesit);
- 136 (94F/42M) pyetësorë online si edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjike, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkisë e këshillit bashkiak të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile, etj.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë drejtpërdrejt zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar kryetarit të bashkisë e stafeve bashkiake të NJVQV, pyetësorë dhe intervista të thëlluara me koordinatorët e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, sekretarët e këshillave bashkiakë, stafet e bashkive dhe aktivistë qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimmarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në regjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit, përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikojnë në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proceset pjesëmarrëse.

Pyetësorët përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorëve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që

ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat dhe informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu u trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokale, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe analizuar. GADC përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet e qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe KB).

Ky raport studimor është një kontribut i rëndësishëm për të kuptuar dhe përmirësuar mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen publike, duke synuar një qeverisje më të hapur, transparente dhe të përgjegjshme në Bashkinë Tiranë. Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare⁷ dhe sekondare⁸ për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndër marrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisë një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

⁷ Si burime primare të informacionit u përdorën ligji nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", informacioni në lidhje me procesin e konsultimit publik të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁸ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Tiranë i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimmarrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
- Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive⁹ të tyre në procesin e vendimmarrjes.

Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që i përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Tiranë:

Zona gjeografike: Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Popullsia: Bazuar në raportimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, popullsia e Tiranës në vitin 2021 rezultoi 863 694 banorë duke pësuar një rritje me 1.5%, krahasuar me vitin 2020 ose 13,164 banorë, ku gjatë vitit 2021, shtesa natyrore e popullsisë është 1,184 banorë (Lindje-Vdekje), duke pësuar një rënie prej 6.3%, krahasuar me një vit më parë. Dendësia e popullsisë së Tiranës u rrit me rreth 8 banorë për km² duke arritur në 777 banorë/km²¹⁰. Ndërkohë që në bazë të të dhënave të publikuara nga Censi 2023, 32% e popullsisë jeton në qarkun e Tiranës nga 2 milionë e 402 mijë e 113 banorë në total të publikuara nga Censi 2023.¹¹

⁹ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

¹⁰ Burimi: <https://opendata.tirana.al/>

¹¹ Cens 2023: <https://www.instat.gov.al/al/cens-2023/>

Administrata e bashkisë Tiranë¹²: Administrata e Bashkisë përbëhet nga: funksionarët (jo nëpunës civil); nëpunësit civilë marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Ligji 152/2015 “Për nëpunësin civil”; punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës (i ndryshuar). Në krye të administratës qëndron Kryetari i Bashkisë, i cili gjatë punës së tij ndihmohet nga katër Zv/Kryetarë dhe Kabineti i Kryetarit (Drejtori i Kabinetit dhe Këshilltarët e Kryetarit), të cilët janë funksionarë (jo nëpunës civil). Administrata e Bashkisë së Tiranës është e organizuar në drejtori të përgjithshme, drejtori, sektorë, zyra dhe njësi. Struktura dhe organika përfundimtare e Aparatit të Bashkisë Tiranë miratohet me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, numri total i Organikës Përfundimtare të Aparatit të Bashkisë Tiranë miratohet nga Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Aparati qendror dhe Njësitë administrative të Bashkisë Tiranë: Në 4-mujorin e parë të 2024, administrata e Bashkisë Tiranë llogaritet në 8,372 punonjës¹³. Sipas Open Data të bashkisë Tiranë¹⁴, në gjashtëmujorin e parë për vitin 2024, administrata e të Bashkisë Tiranë llogaritet në 1,525 punonjës, nga ku 69.9% janë femra dhe 30.1% meshkuj. Rreth 64.7% e punonjësve shërbejnë në aparatin qendror dhe pjesa tjetër prej 35.2% në 24 njësitë administrative të bashkisë dhe tre lagjeve të krijuara në 2018. Si në aparatin qendror dhe njësitë administrative, janë femrat që dominojnë, por diferenca është më e vogël në njësitë administrative.

Struktura e punonjësve, Janar-Qershor 2024, po sipas Open data.

- Femrat përbëjnë 69.9% të punonjësve,
- Në njësitë administrative janë punësuar 35.2% e punonjësve,
- Specialistët përbëjnë rreth 64.5% të totalit të punonjësve,
- Rreth 59.8 % e gjithë punonjësve i përkasin grupmoshës 20-40 vjeç,
- Moshë mesatare e punonjësve të Bashkisë llogaritet 40.3 vjeç,
- Rreth 93.9% e të punësuarëve kanë arsim të lartë dhe pasuniversitar.

Këshilli Bashkiak Tiranë, përbëhet nga 61 anëtarë që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Të ndarë sipas gjinisë janë 31M/30F. Anëtarët e KB kanë ngritur 14 komisione.¹⁵ Si organ përfaqësues aktualisht rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimin e tij me publikun përmes 1 rregulloreje “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Tiranë”,¹⁶ e cila përmban rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak të Tiranës, procedurën e paraqitjes, shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve, sjelljen e këshilltarëve dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre, si dhe marrëdhëniet e këshillit me kryetarin dhe administratën e Bashkisë. Rregullorja është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.42 datë 19.4.2023.¹⁷

¹² Burimi: <https://opendata.tirana.al/administrata-e-bashkise-tirane/>

¹³ Burimi: https://tirana.al/uploads/2024/6/20240618084248_raport-monitorimi-i-bashkise-tirane-per-4-mujorin-2024.pdf

¹⁴ Burimi: <https://opendata.tirana.al/administrata-e-bashkise-tirane/>

¹⁵ Burimi: <https://tirana.al/artikull/komisionet>

¹⁶ Burimi: <https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/rregulloret>

¹⁷ Burimi: <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-tirane-nr-42-date-19-04-2023/>

Bashkia Tiranë si organ ekzekutiv ka miratuar rregulloren “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të bashkisë Tiranë”¹⁸ (Miratuar me Vendim nr.46111 datë 29.12.2022). Në këtë rregullore (Neni 18) specifikohen në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë edhe të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Bashkia Tiranë, në faqen zyrtare¹⁹ ka të publikuar Programin e Transparencës²⁰ në të cilën mund të gjenden informacione të ndryshme si: Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë Tiranë; Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare; Kërkesat për Informacion; Mbi shërbimet që ofron Bashkia Tiranë; Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore; Pjesëmarrja qytetare në vendimarrje apo dhe informacione të tjera të ofruara nga kjo bashki.

Për efekt të studimit më poshtë renditen disa prej proceduarve dhe projektakteve ku bashkia e Tiranës dhe Këshilli Bashkiak janë të detyruar të kryejnë njoftim dhe konsultim publik për qytetarët dhe grupet e interesit:

- Konsultimet me publikun për buxhetin vjetor, sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Këshilli bashkiak zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm (brenda muajit maj) dhe të projekt-buxhetit vjetor.
- Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë deri te versioni final të programit buxhetor afatmesëm, afati nga 30 qershor – 30 shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik realizojnë dëgjesa publike nga 1 shtatori – 30 nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.
- Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.
- Ndryshim destinacioni i pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimarrja i takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.
- Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga administrata e bashkisë ose nga vetë këshilli bashkiak, para miratimit duhet t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik.
- Vendimarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare, p.sh. rrugë publike, parqe eolike, landfill, ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve.

¹⁸ Burimi: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230614140618_rregullore-bashkia-tirane-dhjetor-2022.pdf

¹⁹ Faqe zyrtare e bashkisë Tiranë <https://tirana.al>

²⁰ Burimi: <https://tirana.al/programi-i-transparences>

7. Historiku i Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në bashkinë Tiranë

Për të mbledhur informacione mbi historikun e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Tiranë, janë monitoruar mbledhje të dëgjesave publike dhe janë konsultuar dokumente të ndryshme të publikuara në faqen e internetit të bashkisë Tiranë, si dhe rregullore e urdhra të brendshëm, që janë cituar në sesionin e mëparshëm. GADC duke punuar prej vitesh me bashkinë Tiranë, ka prodhuar dhe raporte të mëparshme monitorimi në këtë fushë, si dhe ka nxitur pjesëmarrjen qytetare në proceset konsultuese sic është buxhetimi me pjesëmarrje apo dhe dëgjesat e realizuara me grupe interesi me të cilat ajo punon prej vitesh edhe në kuadër të Kontratës Sociale POP Tirana.

Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", ligji nr. 119/20214 "Për të Drejtën e Informimit", si dhe ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, pjesëmarrja në vendimarrje merr një rol të rëndësishëm, duke mundësuar një lidhje më të ngushtë midis pushtetit dhe qytetarëve duke rritur përgjegjshmërinë për të ofruar shërbime më të mira dhe më efikase. Në këtë kontekst, pjesëmarrja e qytetarëve në procese të ndryshme vendimmarrëse konsiderohet shumë e rëndësishme.

1. Fillimet e procesit:

2016: Pas miratimit të Ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik," Bashkia e Tiranës filloi të organizojë konsultime publike për projekte të rëndësishme, përfshirë planet urbanistike dhe buxhetin vendor.

2. Platforma dhe mekanizmat:

2018: Për të lehtësuar pjesëmarrjen, Bashkia e Tiranës krijoi platforma online dhe përdori media të ndryshme për të informuar qytetarët rreth çështjeve të konsultuara. Këto përfshinin faqet zyrtare të internetit, rrjetet sociale dhe aplikacionet mobile, të cilat shërbenin për njoftime dhe grumbullim të komenteve dhe sugjerimeve nga qytetarët.

3. Praktikat dhe sfidat:

2019-2020: Ndërsa organizoheshin më shumë takime dhe debate publike, u identifikuan sfida si përfshirja e ulët e qytetarëve, mungesa e informacioneve të mjaftueshme dhe të qarta, si dhe ndonjëherë mungesa e kthimit të përgjigjes për qytetarët që merrnin pjesë në konsultime. Raportet nga organizatat e shoqërisë civile dhe media kanë kritikuar mungesën e transparencës dhe kthimit të përgjigjes.

4. Përmirësimet dhe reformat:

2021: Bashkia filloi trajnime për stafin dhe partnerët e shoqërisë civile për të rritur kapacitetet e tyre në menaxhimin e proceseve të konsultimit publik.

2022: U rrit bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare për të adoptuar praktikat më të mira në transparencën e qeverisjes lokale. Gjithashtu, u promovua pjesëmarrja aktive përmes fushatave ndërgjegjëse.

Historiku i Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik është një histori e vazhdueshme e përmirësimit dhe adaptimit, me synimin për të ndërtuar një qytet më të hapur dhe më demokratik ku qytetarët kanë një zë në vendimmarrje.

Faqja e internetit të bashkisë Tiranë²¹ ka një bazë të dhënash për vazhdimësinë e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik.

Bashkia Tiranë prej 2015 në funksion të procedurave ligjore ka caktuar një person përgjegjës për njoftimin dhe konsultimin publik, ndërsa urdhri i brendshëm (i fundit) nr.24752 datë 05.07.2022, ku përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të koordinorit janë të parashikuara në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Detyrave dhe Kompetencave të administratës së bashkisë Tiranë.²²

Programi i Transparencës është një tjetër dokument i rëndësishëm, që pas miratimit të tij nga autoritetet publike, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, vihet në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet. Ky program, ka si qëllim plotësimin e detyrimit

ligjor për informimin e publikut si edhe transparencën e administratës së bashkisë dhe këshillit bashkiak, për procedurën dhe miratimin e akteve të ndryshme.

Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hartuar urdhrin Nr 211 të datës 10/09/2018 për Hartimin dhe Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Bashkia e Tiranës ka hartuar programin e transparencës²³, i cili paraqet: organizimin dhe funksionimin e bashkisë; transparencën dhe llogaridhënien ekonomiko-financiare; kërkesat për informacion; shërbimet që ofron bashkia; legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në Bashkinë Tiranë; pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje; informacione të tjera të ofruara nga Bashkia Tiranë, si njoftime, sondazhe dhe bashkëpunimin në ofrimin e shërbimeve me shoqërinë civile.

Këshilli Bashkiak publikon njoftimet për mbledhjet kryesisht në mediat sociale si edhe në faqen web të bashkisë. Çdo njoftim përmban të dhëna të plota me datën, vendin, orën dhe rendin e ditës, ndërsa aktet e miratuara shpallen në faqen zyrtare të internetit dhe në standin e njoftimeve publike të Bashkisë Tiranë. Nga monitorimet në faqen web të bashkisë Tiranë për Këshillin bashkiak, regjistrat elektronikë janë publikuar dhe ndahen në:

- **Regjistri për kërkesa dhe ankesa** <https://tirana.al/artikull/regjistri-elektronik-i-kerkesave-dhe-ankesave-keshilli-bashkiak-i-tiranes>

²¹ Faqe zyrtare: <https://tirana.al/>

²² Burimi: Bashkia Tiranë <https://tirana.al/faqe/koordinatori-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik>

²³ Programi I Transparencës bashkia Tiranë: <https://tirana.al/programi-i-transparences>

Përsa i përket Informacionit mbi dëgjesat publike, në faqen web të bashkisë ndodhet ikona përkatëse, por nuk ka mundësi të shkarkohet asnjë raport. Nevojitet që ky seksion të plotësohet me raportet e transparencës në mënyrë periodike.

Ndërkohë që të gjitha **vendimet dhe projekt vendimet e këtij këshilli** janë të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë Tiranë: <https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/vendime-keshilli-bashkiak> të ndara sipas viteve, datave dhe rendit të ditës.

8. Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe realizoi:

- a. Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë;
- b. Realizoi intervista të thëlluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak;
- c. Mnitroji publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta;
- d. Analizoi nga afër konsultime publike nga nxjerrja e projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Rrjeti POP dhe GADC përgatitën një kërkesë për informacion²⁴ drejtuar Bashkisë Tiranë, për të cilën përgjigja u dha me email²⁵. Kërkesa kishte të bënte me "Zbatimin e proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë e Tiranës, për periudhën shtator 2023-maj 2024." Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në Bashkinë e Tiranës, bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik," vuri në dispozicion informacionin e pasqyruar në tabelën më poshtë.

Në tabelën përmbledhëse gjendet informacioni i detajuar mbi përgjigjet e bashkisë, të cilat vlerësohen si të realizuara plotësisht, pjesërisht ose aspak. Komente rreth gjetjeve nga monitorimi janë në dispozicion të lexuesve të këtij raporti, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të procedurave që zbatohen nga Bashkia e Tiranës.

²⁴ Kërkesë për Informim - "Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Tiranë, për periudhën shtator 2023-maj 2024" protokolluar në organizatë me nr.32 në datën 16.05.2024

²⁵ Përgjigje me anë të postës elektronike në datë 16.6.2024

Kërkesa për informacion	Pergjigjet e bashkisë Tiranë dhe Këshilli Bashkiak	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1. Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Z. Dorian Rexhepi Email: konsultimipublik@tirana.al https://tirana.al/faqe/koordinatori-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik	Urdhër i kryetarit të bashkisë nr.24752 datë 05.07.2022. Verifikuar nga organizata via email, sepse urdhrat e brendshëm nuk publikohen në faqen e internetit.	I realizuar
2. Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;	Bashkia Tiranë ka të publikuar online regjistrin elektronik https://tirana.al/kategori/konsultimi-publik Këshilli bashkiak ka një regjistër elektronik ku janë plotësuar kërkesat dhe ankesat nga publiku: https://tirana.al/artikull/regjistri-elektronik-i-kerkesave-dhe-ankesave-keshilli-bashkiak-i-tiranes Bashkia Tiranë si nënkategori të Programit të Transparencës ka të publikuar Regjistrin e kërkesave https://tirana.al/artikull/regjistri-i-kerkesave	Bashkia ka një regjistër elektronik ku janë publikuar njoftimet për konsultimin publik ku përfshihen të dhëna si: data; numri i protokollit; titulli i projektaktit; vendi i takimit; data, ora dhe pjesëmarrja e synuar si dhe afati kohor për të paraqitur rekomandime dhe komente. Gjithashtu ka relacion dhe dokumentat shoqëruese. Pra i gjithë procesi i unifikuar për të gjitha konsultimet publike. Ndërsa, Këshilli Bashkiak megjithëse e ka të publikuar këtë regjistër në faqen e internetit të bashkisë, ai nuk është i aksesueshëm.	I realizuar
3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, te publikuara në programin e	Nën seksionin e programit të transparencës, bashkia Tiranë ka publikuar “Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje” së bashku me dispozitat e brendshme rregullatore	Nëse ndiqet linku i faqes së internetit, hapen më pas njoftimet, konsultimet e regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet	I realizuar pjesërisht

<p>transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”</p>	<p>për këshillim me publikun. https://tirana.al/artikull/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimarrje</p>	<p>publike. Por, nuk ka të ngarkuar një kopje të Planit Vjetor të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes për periudhën 2023 – 2024. Por, ka të ngarkuar Planin Strategjik.</p>	
<p>4. Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Tiranë</p> <ul style="list-style-type: none"> a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues; c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; d) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazeta më të lexuara në nivel kombëtar. 	<p>Njoftimi për projektaktet që i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrin elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) regjistri elektronik b) me postë elektronike; c) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues; <p>Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.</p>	<p>Nga praktika, është vënë re se njoftimet publikohen në regjistrin elektronik në faqen e internetit të bashkisë dhe në mediat sociale të bashkisë dhe KB.</p> <p>Nga intervistat me përfaqësues të bashkisë Tiranë, Publikimi në regjistrin elektronik përdoret gjithmonë; Lajmërimi publik i afishuar në ambientet e bashkisë përdoret ndonjëherë (varet nga procesi); Posta elektronike përdoret për organizatat e shoqërisë civile; rrallë përdoren lajmërimet në mediat audio-vizive; Lajmërimi në mediat sociale përdoret shpesh dhe lajmërimet individuale ndonjëherë.</p>	<p>I realizuar</p>
<p>5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik</p> <ul style="list-style-type: none"> • me postë elektronike; • në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në 	<p>Sipas bashkisë Tiranë, mënyrat e marrjes së komenteve janë kryesisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me postë elektronike; - në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. 	<p>Nga verifikimi dhe dokumentimi i dëgjësave që ka realizuar bashkia Tiranë në periudhën e monitorimit, komente janë marrë me email, sondazh nga pjesëmarrësit apo formë verbale.</p>	<p>I realizuar</p>

procesverbalin e takimeve publike.			
6. A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?	Nu ka patur raste të zgjatjes apo përsëritjes për periudhën e monitorimit (2023-2024)	Nga monitorimi i dokumentacionit të publikuar në faqen e internetit janë respektuar afatet për të paraqitur komentet dhe rekomandimet. Sipas bashkisë Tiranë nuk ka patur raste të tilla.	I realizuar
7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit	Nu ka patur raste të zgjatjes apo përsëritjes për periudhën e monitorimit (2023-2024)		
8. Kopje të njoftimit për takime publike	Faqja web e bashkisë Tiranë. Më poshtë janë disa nga modelet si shpërndahen njoftimet për dëgjesat publike në faqen web të bashkisë. https://tirana.al/artikull/njoftim-per-konsultim-publik-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-vendimin-nr158-date-26122019-te-keshillit-bashkiak-per-sistemin-e-taksave-dhe-tarifave-vendore-ne-qytetin-e-tiranes-te-ndryshuar-26635 https://tirana.al/artikull/njoftim-per-konsultim-publik-propozim-per-shpalljen-park-natyor-bashkiak-pnb-te-zones-kollagjesh-mali-i-fagut https://tirana.al/artikull/njoftim-per-konsultim-publik-draft-strategjia-e-zhvillimit-te-qendrueshem-te-bashkise-tirane-2023-2027	Duke shqyrtuar dokumentacionin vendosur në dispozicion të kërkesës për informim, vihet re se njoftimet janë të unifikuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të bashkisë Tiranë.	I realizuar
9. Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara	Përgatiten për strukturën por në faqen e internetit nuk janë të publikuara (kopjet e procesverbale) për periudhën 2023 – 2024.	Në faqen e webit të bashkisë nuk janë publikuar të gjitha	I realizuar pjesërisht

gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024		procesverbalet e dëgjësive publike të realizuara nga bashkia Tiranë.	
10. Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nuk ka një përgjigje të saktë nga bashkia. Si institucion ata përdorin sondazhe me pjesëmarrësit si p.sh. sondazhi për strategjinë e bashkisë Tiranë.	Nga verifikimi në faqen e internetit ka raporte të projekt aktit por nuk ka të dhëna specifike për rekomandimet e pranuar apo përmbledhje të rekomandimeve apo komenteve të pranuar.	I realizuar pjesërisht
11. Kopje të Raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023	Bashkia Tiranë nuk ka një raport vjetor mbi transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023, por kanë vetëm rezultatet e sondazheve	Pas verifikimit në faqen e internetit dhe komunikimit me Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, është konstatuar se ky raport nuk është publikuar.	I pa realizuar
12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.	Në institucion nuk ka të depozituara ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konsultimin publik	Nga qytetarët apo grupet e interesit nuk ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën shtator 2023– maj 2024.	I realizuar

8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Tiranë:

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Tiranë përfshiu zyrtarë të lartë, dhe drejtues nga drejtoritë dhe sektorët e ndryshëm të bashkisë, të cilët janë të angazhuar në procese që lidhen drejtëpërdrejtë me njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët. Anketimi ka për qëllim të evidentojë dhe të analizojë format dhe instrumentet që përdor Bashkia për të afruar qytetarët më pranë vendimmarrjes. Intervistat shërbyen dhe për të shkëmbyer ide dhe sugjerime për përmirësimin e punës në lidhje me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Në përputhje me detyrimet e parashikuara në Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, të intervistuarit u pyetën nëse bashkia e tyre ka zhvilluar standardizimin e procedurës administrative për njoftimin dhe konsultimin publik (rregullore të brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarde, verifikim). Të gjithë të intervistuarit konfirmuan ekzistencën e procedurave, duke përmendur elementë të caktuar të saj, si urdhrat e brendshëm të Kryetarit të Bashkisë ose personit të autorizuar për njoftimet e dëgjësive publike, format standarde të konsultimit dhe dokumentimit, si edhe një udhëzim të standardizuar që rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit, bazuar në nenet e ligjit.

Të intervistuarit renditën disa prej projektakteve që janë realizuar në konsultim me qytetarët për periudhën shtator 2023 - maj 2024, si p.sh:

- Për projekt-buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2024;
- Konsultimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2023-2027;
- Konsultimi i Projekt-Aktit për miratimin e propozimit për shpalljen “Park natyror bashkiak” (PNB) të zonës “Kollogjesh-Mali i Fagut”;
- Konsultimi i Projekt-Aktit për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar.

Bazuar në eksperiencën e krijuar ndër vite, të intervistuarit nënvizuan se dëgjësia publike për PPV, plane veprimi, plane sociale dhe buxhetimi me pjesëmarrje janë disa prej mekanizmave më efektivë të konsultimit të publikut. Prej vitesh, bashkia dhe stafi i saj realizojnë procedurën e njoftimit dhe konsultimit publik, duke konsultuar projekt-akte të ndryshme, ndërsa theksojnë se procesi ka ardhur duke u përmirësuar bazuar në eksperiencën e fituar.

Kur u diskutua mbi iniciatorët e njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit theksuan se kryesisht ka qenë kryetari i bashkisë, ndërsa në disa raste procese të caktuara kanë qenë kërkesa që vijnë nga Këshilli Bashkiak për të gjitha dëgjësia që kanë karakter social dhe për raste specifike si prishjet e pallateve nga tërmeti. Gjithashtu, janë përfshirë organizata jo-fitimprurëse për projekte dhe çështje të ndryshme, si edhe donatorë të ndryshëm, si rasti i Strategjisë së Bashkisë Tiranë.

Një rëndësi të veçantë për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje ka programi i transparencës, që bashkia ka për detyrë ta miratojë dhe të vendosë në dispozicion të publikut informacione dhe procedura për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hartuar urdhrin Nr. 211 të datës 10/09/2018 për Hartimin dhe Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Bashkia e Tiranës ka hartuar programin e transparencës²⁶, i cili paraqet: organizimin dhe funksionimin e bashkisë; transparencën dhe llogaridhënien ekonomiko-financiare; kërkesat për informacion; shërbimet që ofron bashkia; legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në Bashkinë Tiranë; pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje; informacione të tjera të ofruara nga Bashkia Tiranë, si njoftime, sondazhe dhe bashkëpunimin në ofrimin e shërbimeve me shoqërinë civile.

Në bashkinë Tiranë ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, që është emëruar më 5 korrik 2022 me urdhër vendimi nr. 24752 dhe është nën varësinë e Drejtorisë së Komunikimit me Qytetarët - Sektori i Konsultimit Publik dhe Opinioneve Qytetare. Koordinatori është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit dhe konsultimit publik, të parashikuar nga Ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik". Zakonisht, drejtoritë që përfshihen në procesin e konsultimit publik janë Drejtoria e Menaxhimit Financiar (për procesin e PBA dhe BP); Drejtoria Juridike, Aseteve dhe Licensimit; Drejtoria e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Kabineti i Kryetarit të Bashkisë (Drejtori i Kabinetit dhe këshilltarët e tij); Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve; Sektori i Shërbimeve; Urbanistika; Sektori i Zhvillimit të Komuniteteve; dhe çdo drejtori tjetër që ka lidhje me projekt-aktin që konsultohet.

Kur u diskutua për format e njoftimit dhe përfshirjes qytetare, të gjithë të intervistuarit theksuan se lajmërimet përmes regjistrin elektronik dhe ato individuale janë mënyrat më të praktikuara nga bashkia. Ndërkohë, bëhen njoftime edhe me email apo në mënyrë verbale nga administratorët e lagjeve në qytet dhe administratorët e kryepleqtë në njësitë administrative.

Në lidhje me marrjen e komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, të gjithë të intervistuarit u shprehën se ato diskutohen gjatë dëgjësave publike në formë verbale, që më pas regjistrohen në procesverbal. Gjithashtu, sipas modelit të unifikuar, sipas afatit të vendosur në publikimin e këtij konsultimi, priten komentet/rekomandimet edhe me anë të postës elektronike.

Procesi i njoftimit dhe konsultimit publik (hapat e procesit, përfshirë ideimin e projekt-akteve, njoftimin për konsultimin publik në regjistrin elektronik, numrin e takimeve dhe specifika për çdo takim, ku organizohen, kush merr pjesë, menaxhimi i informacionit dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe ku reflektohen) është organizuar me Urdhër Kryetari për miratimin e Procedures Standarde të Veprimit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik me nr. 33338 datë 22.09.2022.²⁷

²⁶ Programi i Transparencës bashkia Tiranë: <https://tirana.al/programi-i-transparences>

²⁷ Burimi: Koordinatorin për të drejtën e informimit dhe konsultimit publik, bashkia Tiranë

Pjesëmarrja qytetare dhe e grupeve të synuara në proceset me pjesëmarrje arrihet me anë të: Njoftimit në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, Regjistrin elektronik si dhe sondazheve në të gjitha njësitë administrative apo/dhe anketim online dhe telefonik. Njoftimi për projektaktet që i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrin elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:

- a) Publikim në regjistrin elektronik
- b) me postë elektronike;
- c) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues;
- d) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;

Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet me anë të postës elektronike si dhe në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike

Sipas zyrtarëve të Bashkisë Tiranë, disa nga sfidat dhe vështirësitë që janë hasur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik janë:

- Mungesa e interesit të publikut (qytetarë apo organizata të shoqërisë civile) për t'u përfshirë në dhënien e komenteve dhe rekomandimeve.
- Interesi për informacion është rritur, por shkalla e përfshirjes së qytetarëve në procese vendimmarrëse mbetet ende e ulët.

8.2 Gjetje nga intervistat e realizuara me Këshillin Bashkiak Tiranë:

Analiza e mëposhtme vlerëson procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor, me fokus në këshillin bashkiak të Tiranës.

Intervistat në Këshillin bashkiak synojnë të vlerësojnë situatën ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor, duke mbledhur të dhëna për të analizuar efektivitetin dhe sfidat e këtyre proceseve.

Në analizën e perceptimit të rëndësishme të pjesëmarrjes publike, të intervistuarit e kanë vlerësuar si shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendimarrjes së Këshillit Bashkiak, duke përfshirë: Informimin dhe njoftimin e bashkësisë; Këshillimi me bashkësinë si dhe Përfshirjen qytetare në vendimmarrje.

- **Ndërgjegjësimi për Transparencën dhe Përgjegjshmërinë:** Të intervistuarit e vlerësojnë pjesëmarrjen publike si një komponent thelbësor për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri në qeverisjen lokale. Ata besojnë se angazhimi i qytetarëve ndihmon në krijimin e politikave që janë më të lidhura me nevojat dhe interesat e komunitetit.
- **Legjitimiteti i Procesit Vendimmarrës:** Kur pjesëmarrja publike konsiderohet shumë e rëndësishme, proceset vendimmarrëse kanë më shumë mundësi të perceptohen si legjitime dhe të drejta nga komuniteti.
- **Ndikimi në Politikat Publike:** Perceptimi se pjesëmarrja publike është shumë e rëndësishme sugjeron që këshilltarët bashkiakë janë të vetëdijshëm për rolin kritik që

qytetarët dhe grupet e interesit luajnë në hartimin e politikave që janë efektive dhe të zbatueshme.

Të anketuarit shprehen se e njohin bazën ligjore për angazhimin dhe konsultimin e publikut në vendim marrjen vendore, bazuar dhe në rregulloret që janë aprovuar nga Këshilli Bashkiak. Detyrimi i Këshillit Bashkiak për konsultim me publikun garantohet nga ligji Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ligji 146/2014 "Për Njoftim dhe Konsultimin Publik", si dhe Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Bashkiak.

Në vlerësimin e kuadrit ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor, të gjithë të anketuarit e kanë vlerësuar si të qartë dhe të plotë." Kjo tregon se kuadri ligjor ekzistues perceptohet nga të anketuarit si i mirëstrukturuar dhe i mjaftueshëm për të mbështetur proceset e angazhimit qytetar dhe konsultimit publik në nivel vendor. Perceptimi i qartë dhe i plotë i këtij kuadri ligjor sugjeron se ligjet dhe rregulloret aktuale janë të qarta në përmbajtje dhe mbulojnë në mënyrë të plotë nevojat për pjesëmarrjen publike, duke krijuar kështu një mjedis të favorshëm për përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse të qeverisjes vendore.

Në lidhje me rregulloret dhe procedurat e brendshme për realizimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, të anketuarit kanë raportuar se si bazë ligjore përdoret Rregullorja e Këshillit Bashkiak (KB), e miratuar me vendimin Nr. 22, datë 19.04.2023. Kjo rregullore përmban udhëzime dhe procedura specifike për njoftimin dhe konsultimin publik, të cilat janë publikuar edhe në faqen zyrtare online. Kjo tregon një angazhim të institucioneve vendore për të siguruar që proceset e njoftimit dhe konsultimit publik të jenë të rregulluara dhe transparente, duke i ofruar publikut qasje të lehtë në dokumentacionin përkatës.

Përsa I përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, të anketuarit kanë pohuar se ekziston një bashkëpunim midis këtyre dy enteve. Kjo përgjigje pozitive tregon se Këshilli Bashkiak dhe Bashkia punojnë së bashku për të siguruar që proceset e njoftimit dhe konsultimit publik të realizohen në mënyrë të koordinuar dhe efektive, duke përfshirë palët e interesuara dhe qytetarët në vendimmarrjen vendore. Bashkëpunimi ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë në procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik realizohet përmes komunikimit zyrtar me Koordinatorin e Bashkisë. Ky bashkëpunim përfshin gjithë procesin, duke filluar nga njoftimi publik deri te marrja e rekomandimeve nga grupet e interesit dhe komuniteti.

Në kontekstin e njoftimit për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Këshilli Bashkiak përdor një gamë të gjerë mjetesh për të siguruar që qytetarët dhe grupet e interesit janë të informuar në mënyrë të duhur dhe të plotë. Sipas përgjigjeve të marra, këto mjete përfshijnë:

- **Regjistrin elektronik:** Ky mjet mundëson regjistrimin dhe menaxhimin e informacionit në mënyrë dixhitale, që qytetarët dhe palët e interesuara të kenë qasje në informacionin e nevojshëm dhe të ndjekin përditësimet mbi procesin e konsultimit publik.
- **Posta elektronike (e-mail):** Përdorimi i postës elektronike për shpërndarjen e informacionit dhe njoftimeve është një mënyrë efikase për të arritur drejtpërdrejt individë dhe grupe të interesuara, duke ofruar informacion të detajuar dhe mundësi për të dhënë feedback.
- **Lajmërim publik i afishuar në ambjentet e bashkisë:** Ky mjet ofron një mundësi për të informuar publikun që frekuenton hapësirat e bashkisë, duke siguruar që informacioni të jetë i qasshëm për ata që mund të mos përdorin kanale dixhitale.

- **Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj):** Përdorimi i mediave sociale për shpërndarjen e informacionit ndihmon në arritjen e një audience më të gjerë dhe mundëson ndërveprim dhe diskutime në kohë reale në lidhje me procesin e konsultimit publik.

Këshilli Bashkiak ka një mekanizëm të dedikuar për monitorimin dhe raportimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Ky mekanizëm është i strukturur për të siguruar që procesi të monitorohet në mënyrë efektive dhe që rezultatet të raportohen në përputhje me standartet e përcaktuara.

Mekanizmi funksionon në mënyrë të tillë që, pas përgatitjes së raportit nga koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, një grup këshilltarësh është përgjegjës për monitorimin e ecurisë së procesit. Ky grup ndihmon në vlerësimin e efikasitetit të metodave të përdorura dhe në identifikimin e mundësive për përmirësim. Linja e raportimit përfshin analizën e rezultateve të procesit dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësim të mundshme.

Në lidhje me raportimin mbi proceset që rrjedhin nga ligji Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" dhe rekomandimet që dalin prej tij, është konfirmuar se Këshilli Bashkiak merr raportime të tilla. Ky raportim ndihmon në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e implementimit të ligjit dhe rekomandimeve që dalin nga procesi i konsultimit publik.

Kur vjen puna te miratimi i projekt aktet/vendimeve të proceseve të konsultimit dhe rekomandimeve, këto trajtohen në dy mënyra të ndryshme:

1. **Përfshirja në projekt buxhetin e propozuar nga Bashkia:** Kjo metodë sugjeron që rekomandimet dhe projekt aktet e konsultimeve përfshihen në buxhetin e propozuar, duke i dhënë atyre një bazë financiare dhe duke siguruar që ato të jenë të integruara në planifikimin e buxhetit të bashkisë.
2. **Pikë e veçantë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak:** Në këtë rast, rekomandimet dhe projekt aktet diskutohen dhe miratohen si pika të veçanta në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo metodë lejon një shqyrtim të detajuar dhe diskutim të thelluar mbi çdo rekomandim dhe projekt akt, duke e bërë procesin të hapur dhe transparent për anëtarët e këshillit dhe për publikun.

Sipas këshilltarëve të këshillit bashkiak të intervistuar, ka pasur raste kur Këshilli Bashkiak ka kthyer projekt vendime për shkak të mosrealizimit të njoftimit dhe konsultimit publik. Një shembull i tillë është propozimi për shpalljen e "Parkut Natyror Bashkiak të Zonës Lollgjesh-Mali i Fagut". Ky propozim u shty për t'u miratuar pas përfundimit të konsultimit të kryer me komunitetin nga Këshilli Bashkiak, siç është dokumentuar në vendimin nr. 34, datë 28.03.2024.

Në rastin e miratimit të projekt vendimeve që janë marrë në përputhje me njoftimin dhe konsultimin publik, është konfirmuar se Këshilli Bashkiak ndjek zbatimin e tyre. Kjo do të thotë që pas miratimit, Këshilli Bashkiak monitoron dhe mbikëqyr realizimin e vendimeve për të siguruar që ato të zbatohen në përputhje me procedurat dhe qëllimet e përcaktuara gjatë procesit të konsultimit publik.

Për të vijuar, disa nga mekanizmat që Këshilli Bashkiak përdor për të siguruar pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët përfshijnë një sërë aktiviteteve që synojnë përfshirjen e gjerë të

komunitetit dhe grupeve të interesit. Këshilli përdor gjithmonë **buxhetimin me pjesëmarrje**, organizon **seanca dëgjimore** të Këshillit Bashkiak dhe publikon informacion në **faqen e internetit të bashkisë**. Gjithashtu, seancat dëgjimore publike të organizuara nga këshilltarët dhe **konsultimet me ekspertë** janë gjithmonë pjesë e procesit.

Në raste të shpeshta përdoren **diskutime në media lokale** dhe **komisionet këshillimore qytetare**. Në disa raste, përfshihen edhe **studime mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve** dhe **pyetësorë online**. Përdorimi i **mediave sociale**, platformave online dhe komunikimi përmes telefonatave për të informuar qytetarët është gjithashtu i zakonshëm.

Gjatë periudhës shtator 2023 – maj 2024, Këshilli Bashkiak ka kryer konsultime publike për disa akte dhe dokumente të rëndësishme që prekin komunitetin. Këto përfshijnë **buxhetin afatmesëm të bashkisë**, ku është zhvilluar një proces transparent për të marrë mendimet dhe sugjerimet e qytetarëve. Gjithashtu, janë realizuar konsultime për **tarifat dhe taksat**, duke siguruar që komuniteti të ketë një zë në vendosjen e këtyre politikave financiare. Një tjetër aspekt që ka qenë objekt i konsultimeve është **administrimi i aseteve dhe pronave**, ku janë kërkuar rekomandime nga qytetarët dhe grupet e interesit për menaxhimin efektiv të këtyre resurseve.

Këshilli Bashkiak raporton se gjithmonë mat kënaqësinë e qytetarëve lidhur me mekanizmat e përdorur për mbledhjen e mendimeve të tyre. Ky proces është i vazhdueshëm dhe përfshin metoda të ndryshme për të marrë reagimet dhe për të vlerësuar efektivitetin e mekanizmave të pjesëmarrjes dhe konsultimit publik. Sipas përgjigjeve të marra, Këshilli Bashkiak nuk ka patur ankesa nga qytetarët apo grupet e interesit lidhur me pjesëmarrjen qytetare dhe procesin e konsultimit publik. Kjo tregon se deri më tani, mekanizmat e përdorur për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje janë konsideruar të përshtatshëm dhe të pranueshëm nga publiku.

Raportohet se Këshilli Bashkiak ka një sistem monitorimi dhe vlerësimi të mekanizmave të përdorur për pjesëmarrjen dhe konsultimin publik. Ky sistem administrohet nga koordinatori, në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit Bashkiak. Indikatorët kryesorë që maten përfshijnë nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e konsultimit publik dhe reagimet e marra, si përmes ankesave formale, ashtu edhe përmes komenteve dhe reagimeve në rrjetet sociale.

Ndërkohë që, Këshilli Bashkiak nuk miraton raporte vjetore të hartuara për transparencën e proceseve vendimmarrëse. Kjo do të thotë se aktualisht nuk ekziston një praktikë e rregullt për hartimin dhe miratimin e raporteve të tilla që dokumentojnë dhe vlerësojnë transparencën në proceset e vendimmarrjes.

Raportohet se kapacitetet e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për proceset e konsultimit vlerësohen si shumë të afta. Kjo sugjeron se Këshilli është i mirë-organizuar dhe i përgatitur për të menaxhuar dhe realizuar proceset e konsultimit publik në mënyrë efektive. Në lidhje me sfidat, një nga sfidat kryesore që Këshilli Bashkiak ndesh në angazhimin dhe konsultimin me publikun është hartimi i një rregulloreje të veçantë për konsultimin publik. Ky proces kërkon një përpjekje të koordinuar dhe bashkëpunuese nga këshilltarët dhe ekspertët e fushës. Ndër vështirësitë që shfaqen janë sigurimi i një dokumenti të qartë dhe gjithëpërfshirës që të përmbushur nevojat e ndryshme të komunitetit dhe të ndihmojë në përmirësimin e procesit të konsultimit publik.

Për të përmirësuar më tej proceset e angazhimit dhe konsultimit publik, Këshilli Bashkiak ka nevojë për vijimin e asistencës nga ekspertë të huaj dhe vendas. Kjo mbështetje do të ndihmojë

në përmirësimin e mekanizmave të përfshirjes qytetare në vendimmarrje dhe në adaptimin e praktikave më të mira evropiane në këtë drejtim. Ekspertiza e jashtme dhe vendase do të ofrojë njohuri dhe strategji të avancuara për të optimizuar proceset dhe për të siguruar një angazhim më efektiv dhe më gjithëpërfshirës të qytetarëve në vendimmarrjen lokale.

Në përmbyllje, situata mbi zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik raportohet se është e mirë, por sigurisht ka hapësirë për përmirësime. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se janë bërë hapa cilësorë dhe të rëndësishëm në përthithjen e opinionit të komunitetit për vendimmarrjet me rëndësi dhe peshë për mirëqenien e tyre dhe zhvillimin e qytetit. Ky progresi i rëndësishëm tregon angazhimin e Këshillit për të përmirësuar proceset e konsultimit dhe për të siguruar që vendimmarrjet të reflektojnë nevojat dhe interesat e qytetarëve, duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet.


9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit dhe qytetarëve nga konsultimi publik

9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit


Me qëllim matjen e nivelit të njohurive dhe të angazhimit të qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Tiranë, gjatë periudhës maj-qershor ekipi i projektit përgatiti dhe realizoi intervista të thelluara bazuar në një pyetësor të detajuar me 30 përfaqësues të ndryshëm. Nga të cilët, 8 ishin përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, 8 ishin përfaqësues të biznesit lokal dhe 14 ishin qytetarë aktivë, të cilët kanë qenë pjesë e proceseve qoftë për hartimin e Kontratës Sociale Tiranë apo të angazhuar në komunitet.

Pyetjet e intervistës u përqendruan në të drejtat e pjesëmarrjes, format e njoftimit, pjesëmarrjen në konsultime të ndryshme, dhënien e rekomandimeve, bashkëpunimin me pushtetin vendor, dhe sfidat në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Të pyetur mbi informacionin që kanë mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, 27 nga 30 të intervistuarit janë shprehur se kjo është një e drejtë e tyre dhe e shfrytëzojnë atë për të patur bashkëpunim me administratën e bashkisë dhe anëtarët



e Këshillit Bashkiak. Ata janë të ndërgjegjshëm se vendimmarrja e institucioneve vendore sjell impakt të drejtpërdrejtë në komunitet dhe grupet e interesit që përfaqësojnë.



Në lidhje me mjetet e përdorura nga insitucionet vendore për t'i njoftuar për të marrë pjesë në dëgjesat publike, shumica e të intervistuarve kanë referuar se mjetet kryesore që janë njoftuar kanë qënë lajmërimet individuale. Të tjerë të intrevistuar shprehen se janë njoftuar dhe nga adminisratori ose kryeplaku, apo dhe mediat sociale, ndërsa disa OSHC lokale raportojnë se janë njoftuar dhe me email për pjesëmarrje për dëgjesa të ndryshme, kryesisht për plane vendore në fushën sociale, të mjedisit, etj. Nga intervistat e thelluara dalim në konkluzionin se jo të gjithë qytetarët janë të njoftuar në kohë për konsultimet publike.

Të pyetur se në cilat nga proceset konsultuese të bashkisë kanë marrë pjesë, të intervistuarit janë shprehur se kanë marrë pjesë në dëgjesat e projekt-buxhetit për vitin 2024; për planet sociale, strategjinë e bashkisë Tiranë për Barazinë Gjinore. Përgjigjet janë dhënë kryesisht nga qytetarë aktivë. Përsa i përket OSHC-ve ato përgjigjen se ndonjëherë marrin pjesë në konsultime që kanë të bëjnë me miratimin e planeve vendore dhe/ose dëgjesa publike me grupe interesi për buxhetimin me pjesëmarrje.

Të intervistuarit kanë referuar se ndonjëherë kanë dhënë rekomandime me shkrim, por asnjë herë këto komente ata nuk i kanë drejtuar të koordinatori, kryesisht ato janë dërguar me email dhe në zyrën e protokollit të bashkisë. Pjesa më e madhe e të intrevistuarve janë përgjigjur se asnjëherë nuk kanë dërguar komente/rekomandime te koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik.

Lidhur me pyetjen që synoi të evidentonte bashkëpunimet me bashkinë ose Këshillin Bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar, ose organizuar takime publike në favor të grupit që përfaqësojnë, u vërejt se të intervistuarit që përfaqësojnë grupimet e biznesit kanë raportuar se nuk kanë pasur bashkëpunime të tilla. Ndërkohë, pjesa e qytetarëve aktivë kanë deklaruar se kanë bashkëpunime me bashkinë në periudhën e konsultimeve për buxhetimin me pjesëmarrje ndërsa OSHC-të, deklaruan së në raste të ndryshme mund të kenë bashkëpunime por jo shumë domethënëse.

Pjesa më e madhe e të intervistuarve referojnë se rekomandimet që kanë bërë nuk janë marrë parasysh. Të intervistuarit tregojnë stafin e bashkisë; organizatat e shoqërisë civile ose projekte të ndryshme (nga donatorë të huaj) si iniciatorët kryesorë që kanë nisur procesin e njoftimit dhe

konsultimit publik, megjithatë në qasjen e tyre për të ndikuar, ata konsiderojnë bashkinë dhe kryetarin e bashkisë, si institucionin kryesor që udhëheq procesin e konsultimit.

Pjesëmarrësit në këtë anketim u pyetën dhe në lidhje me përvojat dhe perceptimet e tyre lidhur me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Sipas këtyre përgjigjeve, pjesëmarrësit pohojnë se u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit dhe ndikimi që ai mund të ketë, duke treguar se informacioni mbi arsyet dhe ndikimet e projekt-aktit është dhënë përgjithësisht. Kjo tregon përpjekje për të informuar dhe edukuar pjesëmarrësit mbi motivet që qëndrojnë pas veprimeve ose politikave të propozuara, çka është një aspekt thelbësor i qeverisjes transparente dhe konsultimeve publike efektive. Megjithatë, kur u pyetën nëse u ishin dhënë informacionet e duhura për afatin, vendin dhe mënyrën e dorëzimit të rekomandimeve, shumica janë përgjigjur negativisht. Kjo tregon se mund të ketë pasur mungesë qartësie ose komunikimi lidhur me këto aspekte praktike. Një mangësi e tillë është e rëndësishme, pasi pengon pjesëmarrjen efektive dhe parandalon palët e interesuara të kontribuojnë me sugjerimet e tyre në mënyrë domethënëse.

Në pyetjen që lidhet me informacionin për kontaktin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, përgjigjet kanë qenë pozitive që tregon se pjesëmarrësve u është dhënë mundësia për të kontaktuar koordinatorin, gjë që është thelbësore për të kërkuar sqarime të mëtejshme ose për të dorëzuar mendimet dhe komentet e tyre. Një pikë e rëndësishme është edhe koha e vendosur për pjesëmarrje në një konsultim publik. Pjesëmarrësit kanë treguar se koha në dispozicion për të marrë pjesë ka qenë e shkurtër. Ky afat kohor shumë i shkurtër, sipas të intervistuarve paraqet një pengesë serioze për pjesëmarrje efektive, pasi mund të mos lejojë kohë të mjaftueshme për të përgatitur, mbledhur informacion ose formuluar rekomandime të mirëmenduar. Në përmbledhje, ndonëse disa aspekte të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë komunikuar në mënyrë efektive, ka mangësi të dukshme në ofrimin e informacionit të plotë dhe në ofrimin e një periudhe të mjaftueshme për pjesëmarrje. Përmirësimi i këtyre aspekteve mund të rrisë efektivitetin dhe përfshirjen në procesin e konsultimit publik.

Në vijim, në lidhje me marrjen parasysht të rekomandimeve të grupeve të interesit, pothuajse të gjithë të intervistuarit shprehen skeptikë. Edhe pse disa prej tyre kanë arritur disa ndryshime konkrete, të gjithë shprehen se konsultimet publike bëhen sa për procedurë. Qytetarëve nuk u krijohet mjedis mundësues nga administrata e bashkisë dhe anëtarët e KB për të arritur ndryshime reale, për t'u dëgjuar dhe për të reflektuar komente konkrete në projektakte të caktuara. Të gjithë përmendin faktin se besimi publik e pjesëmarrja është në rënie dhe ka nevojë për ndryshime reale që të fitohet besimi i qytetarëve. Fakti që në shumicën e dëgjësave, njerëzit e zakonshëm nuk marrin pjesë dhe e kanë braktisur këtë të drejtë të tyre, sygjeron se procedurat nuk po nxisin një diskutim dhe ndryshim real.

"Ne kemi marrë pjesë në proceset e konsultimit të planeve sociale, përfshirë atë të barazisë gjinore, ku diskutimet dhe sugjerimet janë marrë në konsideratë. Kanë qenë procese të iniciuara nga donatorët si pjesë e procesit të përgatitjes së këtyre planeve."

"Jo, rekomandimet tona nuk janë marrë parasysht. Nuk besojmë se konsultimet publike sjellin ndryshime reale."

"Po, pjesërisht. Mendoj se konsultimet publike janë të rëndësishme dhe një pjesë e rekomandimeve merren në konsideratë."

Të intervistuarit u pyetën gjithashtu në lidhje me sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët dhe grupet e interesit. Një nga sfidat kryesore është mungesa e informacionit, veçanërisht për gratë dhe vajzat në zonat rurale, duke çuar në një përfshirje të kufizuar të tyre në proceset e konsultimit. Një tjetër sfidë është mungesa e formave të ndryshme të njoftimeve, që do të mundësonin informimin e plotë të qytetarëve. Për më tepër, përfshirja e qytetarëve në dëgjesat publike, veçanërisht ato që lidhen me planifikimin e buxhetit për shërbime, është e kufizuar. Kjo është përkeqësuar nga një mungesë e besimit tek autoritetet përgjegjëse, pasi shumë qytetarë ndihen se zëri i tyre nuk do të dëgjohej.

Bashkitë nuk kanë gjetur mekanizmat e duhur për të kryer njoftimet dhe për të përfshirë grupet e interesit në konsultime. Për më tepër, zbatimi i këtij ligji është më i pranishëm në nivel qendror sesa në atë vendor. Njoftimet shpesh vijnë në formë të kufizuar, dhe mungesa e infrastrukturës bën që shumë grupe të mbeten të painformuar dhe pa akses. Ka raste kur qytetarët nuk janë njoftuar dhe janë të informuar vetëm nëpërmjet mediave sociale, si edhe TV, ndërsa Këshilli Bashkiak nuk publikon akte paraprake për konsultim. Gjithashtu, mbledhjet e Këshillit Bashkiak shpesh zhvillohen shpejt dhe nuk referojnë asnjë përmbledhje të rekomandimeve nga grupet qytetare, grupet e interesit dhe OJF-të. Konfliktualiteti mes aktorëve politikë në këto mbledhje gjithashtu pengon pjesëmarrjen efektive të aktorëve publikë.

Në lidhje me pyetjen se a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të informimit dhe konsultimit, përgjigjet e anketuarve janë të larmishme. Disa janë të pasigurt dhe besojnë se, sa më shumë informim të kenë qytetarët dhe kur nevojat ose sugjerimet e tyre të reflektohen në dokumenta ose shërbime, aktivizimi do të rritet. Megjithatë, disa të tjerë nuk kanë vënë re ndonjë ndryshim dhe shprehën se aktivizimi i qytetarëve nuk është rritur. Një pjesë e të anketuarve besojnë se ka patur rritje të aktivizimit dhe disa mendojnë se ndonëse një pjesë e qytetarëve mbetet aktive, duhet bërë më shumë për të ndërtuar një infrastrukturë që mundëson përfshirjen masive. Ka edhe një perceptim që procesi i konsultimit bëhet më shumë në formë formale dhe mbetet i influencuar nga axhendat politike, madje edhe në nivele lokale.


Grupet e interesit listuan një sërë rekomandimesh për përmirësimin e zbatimit të ligjit mbi konsultimin publik në nivel vendor.

- **Informim mbi të drejtat e qytetarëve:** Qytetarët duhet të jenë më të informuar për të drejtat e tyre për të marrë pjesë në këto procese, duke i edukuar mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe përmbushjen e të drejtave të tyre.
- **Fuqizimi i angazhimit qytetar:** Përmes metodave të organizimit komunitar, është e rëndësishme të inkurajohen qytetarët të jenë më aktivë dhe të marrin pjesë në konsultimet publike.
- **Shumëllojshmëria e kanaleve informuese:** Është e nevojshme të përdoren më shumë kanale për njoftimin e qytetarëve, duke përfshirë mjete të ndryshme për të siguruar që informacioni të arrijë tek të gjitha kategoritë shoqërore, duke marrë parasysh aksesin që ato kanë në informacion.
- **Transparenca dhe përfshirja në vendimmarrje:** Qytetarët duhet të jenë të informuar për procesin e vendimmarrjes dhe të kenë mundësi të japin mendimet dhe rekomandimet e tyre, të cilat duhet të merren në konsideratë nga institucionet publike.

- **Konsultime të vazhdueshme:** Njësitë Administrative duhet të kryejnë konsultime të rregullta dhe të vazhdueshme me qytetarët për t'i përfshirë ata në procesin e vendimmarrjes.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes:** Qytetarët duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e pjesëmarrjes në konsultimet publike dhe të inkurajohen të jenë aktivë në këto procese.
- **Monitorimi i procesit:** Duhet të ketë monitorime të konsultimeve publike dhe transparencës në publikimin e dokumenteve përpara miratimit. Gjithashtu, duhet të krijohen platforma për konsultime online dhe të përditësohet informacioni mbi buxhetin dhe politikat në faqet e internetit të bashkive.
- **Edukimi i brezit të ri:** Edukimi i të rinjve mbi rëndësinë e zërit të qytetarëve në diskutimin e çështjeve publike është thelbësor për përfshirjen e tyre aktive në këto procese.
- **Presion pozitiv mbi institucionet:** Duhet të ushtrohet presion pozitiv mbi institucionet për të realizuar efektivisht konsultimet publike, për të ndjekur procedurat dhe për të marrë në konsideratë rekomandimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit.
- **Fushata edukimi dhe informimi:** Institucionet duhet të ndërmarrin fushata edukimi dhe informimi për ligjin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në këto procese.

9.2 Perceptimi qytetar (pyetësori online)

Për të mbledhur perceptimin e qytetarëve në lidhje me njohuritë ose praktikën që kanë mbi njoftimin dhe konsultimin publik; një pyetësor online u përgatit dhe u shpërnda në 10 bashkitë ku Rrjeti POP punon. Në mediat sociale të Rrjetit²⁸ dhe të organizatave lokale pyetësorët u shpërndanë me qëllimin për të matur impaktin që kanë qytetarët mbi procesin. Në lidhje me pyetësorët e shpërndarë online në Tiranë janë plotësuar 136 pyetësorë (64%F/34%M), nga të cilët 94% janë banorë të zonës urbane dhe vetëm 6% janë banorë të zonave rurale të cilët janë angazhuar për t'iu përgjigjur këtij pyetësori.




²⁸ Pyetësori online POP Instagram: <https://www.instagram.com/p/C8B4My6Ng82/>

POP Facebook:

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid0FTax6pM8Kpgsn5i9R9qNygKi6ZwmimuPjeS5SoSvqWgxb3NiHEXwpqjhaTMZT7Nyl>




Pyetësori online POP Twitter: <https://twitter.com/POPAlbania2020/status/1800091792144293993>



Në lidhje me moshën e pjesëmarrësve që kanë plotësuar pyetësonin online, shumica e tyre i përkasin grupmoshave 30-45 vjeç dhe 15-29 vjeç, të cilët janë gjithashtu më aktivë në përdorimin e rrjeteve sociale. Kjo ndarje sipas moshave dhe gjinisë është bërë për të siguruar një analizë më të detajuar dhe të saktë të rezultateve, duke na lejuar të

kuptojmë se si faktorë të tillë ndikojnë në perceptimet dhe sjelljet e individëve.


136 qytetarët e Tiranës të angazhuar në këtë studim informuan për njohuritë dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset publike. Rezultatet tregojnë një ndarje të barabartë në njohuritë e qytetarëve mbi ligjin për konsultimin publik: 50% e pjesëmarrësve janë të informuar, ndërsa 50% të tjerë nuk janë. Kjo ndarje tregon nevojën për edukim të mëtejshëm dhe rritjen e ndërgjegjësimit në këtë fushë, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së të gjithë qytetarëve në vendimmarrje publike. Ndarja gjinore e pjesëmarrësve që kanë njohuri mbi këtë proces tregon një dominim të grave, me 70% të tyre që përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve, në krahasim me 30% të meshkujve. Kjo tregon një angazhim më të madh të grave në çështjet publike, veçanërisht në grupmoshat më të reja. Ndërkohë që vetëm 24 (17.6%) nga personat që iu përgjigjën këtij pyetësoni kanë marrë pjesë në dëgjuesat e organizuara nga bashkia apo këshilli bashkiak Tiranë. Grupmosha 30-45 vjeç përbën pjesën më të madhe të pjesëmarrësve, të interesuar dhe të angazhuar në çështje publike. Pas tyre vijnë ata në moshën 46-65 vjeç, ndërsa angazhimi bie ndjeshëm në grupmoshat e tjera. Kjo analizë tregon se për të përmirësuar përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, është e rëndësishme të synohen fushata edukative dhe ndërgjegjësuese që përfshijnë të gjitha grupmoshat dhe të dyja gjinitë, me një fokus të veçantë në inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe grave.



Qytetarët u pyetën gjithashtu se pse nuk marrin pjesë në dëgjesat publike të organizuara nga pushteti vendor. Bazuar në të dhënat e marra, arsyeja kryesore që qytetarët nuk marrin pjesë në dëgjesat publike është mungesa e informacionit, me 38.3% të të anketuarve që shprehen se nuk kanë njoftim se kur mbahen këto konsultime. Për më tepër, 18.1% e qytetarëve ndihen të pasigurt se mendimet e tyre do të merren parasysh, duke treguar një mungesë besimi në procesin e vendimmarrjes. Një numër i konsiderueshëm, 16.8%, shprehen se nuk janë të interesuar në këto konsultime, ndërsa 16.3% nuk janë të informuar për të drejtat e tyre për të bërë komente ose ndryshime në vendimet e bashkisë. Ndërsa, 10.6% kanë dhënë përgjigje të tjera, ku rezultoi se shumica kanë vështirësi të lidhura me angazhimet personale dhe profesionale. Shumë persona shprehen se nuk kanë kohë ose se janë të angazhuar gjatë orareve të konsultimeve, duke përfshirë dhe ata që punojnë dhe nuk kanë mundësi të marrin leje nga puna. Disa të tjerë nuk janë informuar ose nuk e dinë ku duhet të interesohen për të marrë pjesë. Ka edhe raste specifike ku qytetarët ndihen të përjashtuar ose të pavlefshëm në proceset publike, duke nxjerrë në pah se vetëm organizatat e shoqërisë civile janë të kontaktuara nga bashkia. Këto rezultate tregojnë një nevojë të qartë për përmirësimin e komunikimit dhe edukimit të qytetarëve në lidhje me proceset publike, si dhe për të rritur besimin dhe interesin e tyre në pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje.

Qytetarët që i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes nëse kanë marrë pjesë në dëgjesat publike, që përbëjnë 17.6% të të gjithë të intervistuarve, u pyetën për mënyrat se si janë informuar për procesin. Nga të dhënat e mbledhura, duket se shumica e qytetarëve janë informuar për dëgjesat publike kryesisht përmes lajmërimeve individuale, me 13 persona që kanë raportuar këtë metodë. Pas kësaj, një pjesë e konsiderueshme janë informuar përmes administratës lokale, kryeplakut ose ndërlidhësit komunitar, me 8 persona që kanë përmendur këtë burim. Mediat sociale dhe email-i kanë luajtur një rol informimi, me 4 qytetarë që janë informuar përmes secilës nga këto metoda. Nuk është raportuar asnjë njoftim përmes regjistrit elektronik ose faqes web të bashkisë. Këto të dhëna tregojnë rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të personalizuar për informimin e qytetarëve mbi aktivitetet publike.


MËNYRAT E NJOFTIMIT




Në lidhje me pyetjen nëse janë marrë në konsideratë vërejtjet, sugjerimet, ose komentet e pjesëmarrësve në dëgjesat publike, përgjigjet janë të ndryshme. Një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve, konkretisht 13 persona, nuk janë të sigurtë ose nuk e dinë nëse sugjerimet e tyre janë marrë parasysh. Nga ana tjetër, 7 qytetarë besojnë se vërejtjet e tyre janë marrë në konsideratë, ndërsa 2 të tjerë mendojnë se janë marrë pjesërisht. Ndërkohë, 4 persona shprehen se sugjerimet e tyre nuk janë marrë parasysh. Këto përgjigje sugjerojnë një ndjenjë të përzier në

lidhje me efektivitetin e përfshirjes së qytetarëve dhe ndikimin e tyre në procesin e vendimmarrjes publike.

Në lidhje me pyetjen për ankesat e pjesëmarrësve në procesin e konsultimit publik, përgjigjet tregojnë një përqindje të ulët të pjesëmarrësve që kanë bërë ankesa dhe marrë përgjigje ndaj ankesave të tyre. Nga 136 persona që iu përgjigjën anketës, vetëm 5 (3.7%) kanë deklaruar se janë ankuar dhe kanë marrë një përgjigje. Ndërkohë, një numër më i madh, 12 persona (8.8%), kanë thënë se janë ankuar por nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Gjithashtu, shumica dërrmuese prej 119 pjesëmarrësish (87.5%) kanë deklaruar se nuk janë ankuar fare. Këto të dhëna sugjerojnë se ekziston një mungesë përgjigjeje ndaj ankesave dhe një ndjenjë e ulët e përfshirjes nga ana e qytetarëve në procesin e konsultimit publik.



Në sesionin e fundit, qytetarët u pyetën nëse vendimmarrja në interes të tyre do të përmirësohej



nëse do të zbatoheshin me përpikmëri procedurat e konsultimit publik. Nga 136 qytetarë të anketuar, 67% besojnë se ndjekja e këtyre procedurave do të çonte në një përmirësim të vendimmarrjes. Ndërsa 32% qytetarë të tjerë nuk pajtohen me këtë mendim.

Për ta përmbyllur si anketim, qytetarët u pyetën gjithashtu për opinionet e tyre në lidhje me problematikat që ka

konsultimi publik pranë bashkisë Tiranë. Nga vlerësimet e qytetarëve mbi problemet e konsultimit publik, dalin në pah disa çështje kryesore që ndikojnë në efektivitetin dhe përfshirjen e qytetarëve në këtë proces. Mungesa e njoftimeve në kohë për draft vendimet është identifikuar si problem nga 47% qytetarë, duke treguar një mungesë transparence dhe akses në informacione të rëndësishme. Konsultimet publike formale të organizuara nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak janë përmendur si një çështje nga 38% qytetarë, duke nënkuptuar se këto procese shpesh mund të jenë më shumë formalitete sesa mundësi reale për dialog. Një numër i barabartë qytetarësh kanë shprehur shqetësime se konsultimet nuk përfshijnë grupet e dhura të qytetarëve dhe të interesit, duke lënë jashtë procesit zëra të rëndësishëm.

Gjithashtu, 17% e qytetarëve janë shprehur se nuk kanë mundësi të shprehin mendimet e tyre alternative gjatë konsultimeve, ndërsa 21% të tjerë kanë theksuar mungesën e mundësive për të diskutuar dhe mungesën e materialeve shoqëruese në rastet kur marrin pjesë. Një tjetër problem i shprehur është mosmarrja parasysh e rekomandimeve nga qytetarët dhe grupet e interesit, e raportuar nga 32% qytetarë, duke ngritur shqetësime mbi seriozitetin e procesit dhe ndikimin e tij real në vendimmarrje. Së fundi, mungesa e interesit nga ana e qytetarëve për të marrë pjesë në këto konsultime është shënuar nga 29% qytetarë, duke sugjeruar një shkallë të ulët të

angazhimit dhe përfshirjes qytetare. Këto të dhëna tregojnë nevojën për përmirësime në komunikim, përfshirje dhe seriozitet në trajtimin e konsultimeve publike nga autoritetet lokale.

10. Konkluzione dhe Rekomandime

Analiza e praktikave të njoftimit dhe konsultimit publik nga Bashkia e Tiranës tregon disa aspekte pozitive dhe disa sfida që ende kërkojnë përmirësim. Një nga përparësitë kryesore është emërimi i Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe implementimi i një regjistri elektronik online për projektaktet dhe njoftimet për konsultim, që lehtëson aksesin në informacion për qytetarët. Megjithatë, ndonëse ka disa praktika të mira, si përdorimi i regjistrit elektronik dhe forma të ndryshme njoftimi, disa probleme kanë dalë në pah.

Për shembull, Plani Vjetor i Vendimmarrjes për periudhën 2023-2024 nuk është në dispozicion, duke ulur transparencën e procesit të vendimmarrjes. Po ashtu, mungesa e publikimit të procesverbaleve të takimeve publike dhe raportit vjetor për transparencën janë çështje që ndikojnë në efektivitetin e procesit të konsultimit publik. Të dhënat nga intervistat dhe pyetësorët tregojnë gjithashtu një angazhim të ulët nga qytetarët dhe grupe të interesit, për shkak të mungesës së informacionit dhe periudhave të shkurtra për pjesëmarrje.

Sa i përket Këshillit Bashkiak, një nga sfidat kryesore në angazhimin dhe konsultimin me publikun është hartimi i një rregulloreje të veçantë për konsultimin publik. Kjo rregullore duhet të jetë rezultat i një pune të përbashkët të këshilltarëve dhe ekspertëve të fushës. Angazhimi i efektshëm dhe konsultimi me publikun kërkojnë një kornizë të qartë dhe të strukturuar që e bën procesin më të organizuar dhe të koordinuar, duke adresuar kështu nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve në mënyrë më të efektshme.

Grupet e interesit, përfshirë OSHC-të dhe bizneset lokale, kanë raportuar se njoftimet shpesh ndahen në grupe të mbyllura dhe se shumë rekomandime nuk reflektohen në dokumentet finale. Mungesa e informacionit dhe përfshirja e kufizuar e grupeve të interesit janë sfida të tjera që kërkojnë vëmendje. Pjesëmarrësit në pyetësorët online janë të shqetësuar për mungesën e njoftimeve në kohë dhe për format formale të konsultimeve që nuk nxisin diskutime të thella.

Rekomandime për bashkinë:

- **Përmirësimi i Publikimit të Dokumenteve:** Publikimi i rregullt i Planit Vjetor të Vendimmarrjes dhe procesverbaleve të takimeve publike është i nevojshëm për të rritur transparencën dhe përfshirjen.
- **Rritja e Aksesit në Informacion:** Sigurimi i aksesit të lehtë dhe të plotë në të gjitha dokumentet dhe raportet, duke përfshirë përmbledhjet e rekomandimeve dhe raportet e projektakteve.
- **Zgjerimi i Kanaleve të Njoftimit:** Përdorimi i formave të ndryshme të njoftimeve dhe përfshirjes për të arritur një audiencë më të gjerë dhe për të rritur angazhimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

- **Përmirësimi i Procedurave për Marrjen e Komenteve:** Rritja e periudhës së dorëzimit të rekomandimeve dhe ofrimi i informacionit të plotë mbi ndikimin e mendimeve të qytetarëve.
- **Përmirësimi i Angazhimit të Qytetarëve:** Zhvillimi i strategjive për të rritur pjesëmarrjen qytetare dhe për të adresuar shqetësimet e ngritura nga qytetarët dhe grupet e interesit.
- **Trajnimi dhe Ndihma për Grupe Sociale dhe Rurale:** Sigurimi i informacionit dhe mundësive të barabarta për gratë dhe vajzat në zonat rurale për t'u përfshirë në proceset e konsultimit publik.

Rekomandime për Këshillin Bashkiak:

- **Rregullorja për Konsultimin Publik:** Hartimi i një rregulloreje të veçantë për konsultimin publik, duke u bazuar në një proces të detajuar dhe të strukturuar. Ky dokument duhet të krijohet në bashkëpunim të ngushtë me këshilltarët dhe ekspertët e fushës për të siguruar një kornizë të qartë dhe efektive për angazhimin e qytetarëve.
- **Nevojat për Përmirësimin e Proceve:** Vijueshmëria e asistencës nga ekspertë për të përmirësuar mekanizmat e përfshirjes qytetare në vendimmarrje. Kjo mbështetje mund të ndihmojë në adaptimin e praktikave më të mira europiane dhe në rritjen e efikasitetit të proceseve të konsultimit.
- **Vlerësimi i Mekanizmave për Angazhimin Qytetar:** Vlerësimi i ecurisë së mekanizmave dhe se si kanë ndikuar në vendimmarrjen dhe zhvillimin e qytetit. Ndërmerrja e hapave për të monitoruar dhe rishikuar vazhdimisht mekanizmat për angazhimin qytetar për të identifikuar dhe adresuar çdo mangësi.

Rekomandime për Grupet e Interesit

- **Pjesëmarrja Aktive:** Angazhimi më aktiv në proceset e konsultimit dhe ofrimi i rekomandimeve të qarta dhe të arsyetuara.
- **Përmirësimi i Komunikimit:** Përdorimi i kanaleve të ndryshme për të siguruar që rekomandimet dhe komentet të arrijnë në administratën e bashkisë dhe të merren në konsideratë.
- **Pjesëmarrja në Dëgjesa dhe Konsultime:** Rritja e angazhimit në dëgjesat publike dhe konsultimet për projekte dhe plane që ndikojnë në interesat e grupeve me të cilat punojnë.
- **Përmirësimi i Bashkëpunimit:** Forcimi i bashkëpunimit me administratën e bashkisë dhe advokimi për më shumë transparencë në reagimin ndaj rekomandimeve dhe sugjerimeve të bëra.

Rekomandime për qytetarët

- **Rritja e Pjesëmarrjes në Dëgjesat Publike:** Angazhimi në dëgjesat publike dhe konsultimet për të shprehur mendimet dhe rekomandimet.
- **Përdorimi i Kanaleve të Informimit:** Shfrytëzimi i kanaleve të njoftimeve dhe informacionit të ofruara nga bashkia, përfshirë regjistrin elektronik.

- **Pjesëmarrja në Proceset e Konsultimit:** Dhënia e komenteve dhe rekomandimeve të detajuara në proceset e konsultimit dhe angazhimi në përmirësimin e vendimmarrjes publike.
- **Raportimi i Mungesës së Informacionit:** Njoftoni organizatat e shoqërisë civile apo/dhe bashkinë për çdo mungesë informacioni ose sfida në pjesëmarrjen tuaj në proceset e konsultimit.

11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)

- Administrata Bashkia Tiranë – Faqe zyrtare <https://opendata.tirana.al/administrata-e-bashkise-tirane/>
- Administrata e Bashkisë Tiranë sipas Open Data Tirana: <https://opendata.tirana.al/administrata-e-bashkise-tirane/>
- Cens 2023: <https://www.instat.gov.al/al/cens-2023/>
- Faqe zyrtare e bashkisë Tiranë <https://tirana.al>
- Faqe Zyrtare e Rrejtit POP <https://popNetwork.al/>
- Faqe Zyrtare GADC: <https://gadc.org.al/>
- Komisionet e Këshillit Bashkiak: <https://tirana.al/artikull/komisionet>
- Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://tirana.al/faqe/koordinatori-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik>
- Ligji për konsultimin publik në nivel vendor <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>
- Njoftim për konsultim publik- Draft-Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2023-2027: <https://tirana.al/artikull/njoftim-per-konsultim-publik-draft-strategjia-e-zhvillimit-te-qendrueshem-te-bashkise-tirane-2023-2027>
- Njoftim për konsultim publik- Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës, të ndryshuar: <https://tirana.al/artikull/njoftim-per-konsultim-publik-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-vendimin-nr158-date-26122019-te-keshillit-bashkiak-per-sistemin-e-taksave-dhe-tarifave-vendore-ne-qytetin-e-tiranes-te-ndryshuar-26635>
- Njoftim për konsultim publik- Propozim për shpalljen "Park Natyror Bashkiak" (PNB), Të zonës "Kollagjesh- Mali i Fagut": <https://tirana.al/artikull/njoftim-per-konsultim-publik-propozim-per-shpalljen-park-natyror-bashkiak-pnb-te-zones-kollagjesh-mali-i-fagut>
- Open Data bashkia Tiranë: <https://opendata.tirana.al/>
- Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje: <https://tirana.al/artikull/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje>
- Programi I Transparencës Bashkia Tiranë: <https://tirana.al/programi-i-transparences>
- Pyetësi Online POP Facebook: <https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid0FTax6pM8Kpgsn5i9R9qNygKi6ZwmimuPjeS5SoSvWgxb3NiHEXwpqjhaTMZT7Nyl>
- Pyetësi Online POP Instagram: <https://www.instagram.com/p/C8B4My6Ng82/>
- Pyetësi Online POP Twitter: <https://twitter.com/POPAlbania2020/status/1800091792144293993/photo/1>

- Raport Monitorimi Bashkia Tiranë: https://tirana.al/uploads/2024/6/20240618084248_raport-monitorimi-i-bashkise-tirane-per-4-mujorin-2024.pdf
- Raport studimor GADC – POP 2022: <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-tirane/>
- Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike: <https://tirana.al/kategori/konsultimi-publik>
- Regjistri i Kërkesave – Programi I Transparencës: <https://tirana.al/artikull/regjistri-i-kerkesave>
- Regjistri për kërkesa dhe ankesa Këshilli Bashkiak Tiranë: <https://tirana.al/artikull/regjistri-elektronik-i-kerkesave-dhe-ankesave-keshilli-bashkiak-i-tiranes>
- Rregullore për “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të bashkisë Tiranë”: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230614140618_rregullore-bashkia-tirane-dhjetor-2022.pdf
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Tiranë: <https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/rregulloret>
- Vendime të Këshillit Bashkiak: <https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/vendime-keshilli-bashkiak>
- Vendimi për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Tiranë: <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-tirane-nr-42-date-19-04-2023/>

12. Anekse

Ankesi 1. Kërkesa zyrtare drejtuar bashkisë Tiranë

Aneksi 2. Pyetësi i Intervistave të thelluara me stafin e bashkisë

Aneksi 3. Pyetësi i Intervistave të thelluara me Këshillin Bashkiak

Aneksi 4. Pyetësi i intervistave të thelluara me grupet e interesit

Aneksi 5. Pyetësi për qytetarët online

Adresa: Rruga "Abdyl Frasheri" Pall 10/1, Tiranë

Email: gadc@gadc.org.al

Tel: +355 4 22 555 14

Nr.32.prot.

Data 16.05.2024

Kërkesë për informim

Drejtuar: Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në bashkinë Tiranë shtator 2023 – maj 2024

I nderuar z.Kryetar,

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP)¹ po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Tiranë për periudhën shtator 2023 – maj 2024. Ky raport studimor po realizohet në 10 bashki të vendit ku Rrjeti POP operon: Durrës; Elbasan; Fier; Kukës; Korçë; Pukë; Shkodër; Tiranë; Vau i Dejës dhe Vlorë. Në këtë kuadër, kemi nevojë për bashkëpunimin me bashkinë Tiranë për disa informacione në mënyrë që të pasqyrojmë në mënyrë sa më të drejtë dhe bazuar në fakte zbatimin e këtij procesi.

Për këtë arsye do ju luteshim që të na informoni me:

- Emrin dhe kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të saj/tij.
- Linkun e regjistrimit elektronik ku janë publikuar Projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve.²

Më pas, bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si edhe Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", do të kontaktojmë me personin përgjegjës në mënyrë që të marrim informacionin e nevojshëm sipas Aneksit nr. 1 të kësaj kërkesë.

Mbetemi në pritje të informacionit të kërkuar, të cilin mund të na e dërgoni edhe në adresën elektronike gadc@gadc.org.al

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Sinqerisht

Esmeralda Hoxha
Koordinatorë e Rrjetit „Përballja e Ofertave Politike“ (POP)

¹ Faqja zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>

² Sipas detyrimit të percaktuar në nenin 6, pika 1, germa a) e ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

Adresa: Rruga "Abdyl Frasheri" Pall 10/1, Tiranë

Email: gadc@gadc.org.al

Tel: +355 4 22 555 14

Aneks nr. 1: Kërkesat specifike për informacion sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si edhe Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

- 1) Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, të publikuara në programin e transparencës.³
- 2) Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik⁴
 - *me postë elektronike;*
 - *me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;*
 - *me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;*
 - *me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.*
- 3) Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik.⁵
 - *me postë elektronike;*
 - *në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.*
 - *Tjetër (ju lutem specifikoni)*
- 4) A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit? Nëse Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit.⁶
- 5) Kopje të njoftimit për takime publike.⁷
- 6) Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024.⁸
- 7) Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"⁹
- 8) Kopje të Raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023.¹⁰
- 9) A ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik? Nëse po ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.¹¹

³Sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

⁴ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 11 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

⁵ Si më lart

⁶ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 16 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

⁷ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 17 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

⁸ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 18 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

⁹ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 19 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

¹⁰ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 20 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

¹¹ Në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" dhe nenit 21 të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

PYETËSORI PËR STAFIN E BASHKISË

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuar për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për bashkinë:

Bashkia _____

Nr. i njësive administrative _____

Nr. i banorëve _____

Mbulimi territorial _____

Numri i punonjësve (F/M) _____

1. A ka zhvilluar bashkia juaj standartizim të procedurës administrative të njoftimit dhe konsultimit publik? (rregullore e brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarte, verifikim)

Po

Jo

2. A ka zhvilluar bashkia juaj ndonjë mekanizëm apo proces të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët? (si psh: dëgjesa publike për PPV, dëgjesa për dhëgjesa për dhënie të pronave, plane veprimi, dëgjesa për Buxhetimin me Pjesëmarrje, etj)? Nëse po, cilët janë ato për periudhën shtator 2023 – Maj 2024?

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

3. Ndër ta, cilin do veçonit si një ndër mekanizmat që ka rezultuar më efektiv?

4. Prej sa kohësh janë realizuar dëgjesa dhe konsultime publike në bashkinë tuaj?

- Më pak se 6 muaj
- 6 muaj – 1 vit
- 1 – 3 vit
- Mbi 3 vjet (specifiko sa) _____

5. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

- Këshilli Bashkiak
- Kryetari i Bashkisë
- Stafi i Bashkisë
- Organizata jofitimprurëse lokale
- Projekt i realizuar me donatorë
- Tjetër (specifiko) _____

6. A ka vendime, urdhëra të brendshëm të miratuara nga Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak për programin e transparencës (verifikoni në disa raste është kërkuar të rishikohen programet e transparencës për 2023 - 2024?

Po Jo

7. Nëse po, ju lutem siguroni një kopje elektronike të dokumentacionit për efekt studimi, verifiko nëse plotësohen kërkesat e fushës 6 – Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje?

8. Nëse ka pak informacion dhe ato janë pjesërisht të publikuara në faqen e internetit, pse?

- Mendoni që nuk është e nevojshme
- Nuk ka kapacitete brenda bashkisë për të hartuar një dokumentacion të tillë
- Nuk keni gjetur një praktikë për t'u përshtatur në bashkinë tuaj
- Tjetër

9. Si është i organizuar procesi i njoftimit dhe konsultimit publik (hapat e procesit, përfshirë ideimin e projekt-akteve, njoftimin për konsultimin publik në regjistrin elektronik, numrin e takimeve dhe specifika për çdo takim, ku organizohen, kush merr pjesë, menaxhimi i informacionit dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe ku reflektohen).

10. A ka bashkia juaj Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Kush është përgjegjës për këtë strukturë? (saktësoni drejtorinë nga varet ky pozicion)?

11. Cilat drejtori apo sektore të tjerë të Bashkisë përfshihen në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik?

12. Si e siguron pjesëmarrjen e gjithë grupeve të synuara në proceset me pjesëmarrje?

13. Cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve në këtë proces? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Regjistri elektronik	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale (Facebook etc)	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale					
Botim në gazetat lokale	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

14. Si merren komentet dhe rekomandimet në procesin e konsultimit publik në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A shpjegohen arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë?
 Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre? Po Jo

A afishohet/publikohet adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?

Po Jo

A publikohet dhe kur publikohet vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

15. A keni regjistër ose plan vjetor për procesin e vendimmarjes me pjesmarrje (dëgjesat publike)?

Po Jo

16. Si funksionon ky regjistër/plan? A përditësohet sistematikisht? (Verifiko faqen zyrtare e internetit ku publikohen projekt-aktet, që ngarkon me përgjegjësi organet që duhet të publikojnë të gjithë procedurën e konsultimit publik të projekt-aktit)

17. Kush është përgjegjës për përditësimin e tij?

18. Është i publikuar ky regjistër/ plan vjetor(online)?

Po Jo

19. A mbahet dhe publikohet procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun?

Publikimi online	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Procesverbali i takimeve	1	2	3	4	5

20. Keni statistika mbi përfshirjen e qytetarëve? Nëse po, specifikoni edhe me shifra (kjo pyetje për koordinitorin e Konsultimit Publik, drejtoritë e tjera nuk kanë statistika, thjesht merrni ndonjë ide sa informacione kanë)?

Total _____

Të ndarë sipas gjinisë _____

- Të ndarë sipas njësive administrative _____
- Organizata jofitimprurëse lokale _____
- Subjekte private _____
- Të rinj _____
- Persona të papunë _____
- Persona me nevoja të veçanta _____
- Të pastrehë _____
- Tjetër _____

21. A keni sistem monitorimi dhe vlerësimi të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik?

Po Jo

22. Nëse po, jepni më shumë informacion mbi të (indiktorët që maten, kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin).

23. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në bashkinë tuaj?

24. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

25. Nëse po/jo shpjegoni si:

26. Cilat do të ishin nevojat për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

- Procedura
- Burime njerëzore
- Burime financiare
- Burime materiale

- Infrastrukturë e përshtatshme
- Asistencë teknike/Trajnime
- Tjetër

27. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

PYETËSORI PËR KËSHILLTARËT BASHKIAKË

VLERËSIMI I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR PER KESHILLIN BASHKIAK

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Pwrballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuara për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për këshillin bashkiak:

Bashkia _____
Nr. i këshilltareve _____
Nr. i ndarë sipas gjinisë _____
Nr. i komisioneve _____

1. Në opinionin tuaj si këshilltar vendor, sa e rëndësishme është pjesëmarrja e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendimarrjes së Këshillit Bashkiak?

Perceptimi	Shumë e rëndësishme	E rëndësishme	Disi e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Aspak e rëndësishme
Këshillimi me bashkësinë	1	2	3	4	5
Informimi dhe njoftimi i bashkësisë					
Përfshirja qytetare					

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

2. Nëse Po, ju lutem jepni sqarime për alternativën e zgjedhur.

3. A e njihni bazën ligjore për angazhimin dhe konsultimin e publikut në vendim marrjen vendore? (Saktëso nëse ka rregullore të KB dhe nëse e kanë lexuar apo e kanë bërë pjesë të punës së tyre)

4. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor? (mund të zgjidhni më shumë se sa një alternativë)

- Është i qartë dhe i plotë
- Është i qartë, por jo i plotë
- Është i paqartë, por i plotë
- Është i paqartë dhe jo i plotë

5. Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?

6. Keni rregullore dhe procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik? Nëse po, ju lutem specifikoni. (Shënim për intervistuesin: Të merret një kopje e dokumentacionit, të specifikohet nr. i vendimit të rregullores së KB)

7. A ka bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit publik?

Po Jo

8. Nëse po, si realizohet ky bashkëpunim?

9. A ka Këshilli Bashkiak infrastrukturën e duhur për realizimin dhe ndjekjen e proceduarve të ligjit për njoftimin dhe konsultimit publik?

Po Jo

10. Në dijëni tuaj, cilat janë mjetet që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik:

- Regjistri elektronik
- Posta elektronike (e-mail)
- Lajmërim publik i afishuar në ambjentet e bashkisë
- Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
- Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
- Botim në gazetatat lokale
- Tjetër (ju lutem specifikoni) _____

11. A ka Këshilli një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për Njoftimin dhe Konsultimin Publik?

Po Jo

12. Nëse po, ju lutem shpjegoni si funksionon ky mekanizëm, cila është linja e raportimit, kush e monitoron?

13. A raportohet në Këshillin Bashkiak mbi proceset që rrjedhin nga ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe rekomandimet që dalin prej tij?

Po Jo

14. Nëse po, si i miratoni projekt aktet/vendimet e proceve të konsultimit dhe rekomandimet që dalin prej tij?

- Të përfshira në projekt buxhetin e propozuar nga Bashkia
- Pikë e veçantë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak
- Tjetër (ju lutem specifikoni)

15. A ka patur raste të kthimit të projekt vendimeve nga Këshilli Bashkiak për shkak të mosrealizimit të njoftimit dhe konsultimit publik? Nëse po, specifikoni.

16. Në rastin e miratimit të projekt vendimeve që janë marrë bazuar në njoftimin dhe konsultimin publik, a ndiqet nga ana e Këshillit Bashkiak zbatimi i tyre:

Po Jo

17. Cilat jane disa nga mekanizmat e pjesëmarrjes dhe konsultimit që Këshilli juaj përdor me qytetarët:

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Buxheti me pjesëmarrje	1	2	3	4	5
Seanca dëgjimore të Këshillit Bashkiak	1	2	3	4	5
Faqja e internetit e bashkisë	1	2	3	4	5
Diskutime në media lokale	1	2	3	4	5
Seanca dëgjimore publike organizuar nga këshilltarët	1	2	3	4	5
Takimet në lagje, fshatra, njësi administrative					
Komisionet këshillimore qytetare	1	2	3	4	5
Konsultime me ekspertë	1	2	3	4	5
Studimet mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve	1	2	3	4	5
Mediat sociale, platformat online ose telefonatat	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

18. Për cilat akte/dokumenta të përmendura mëposhtë keni kryer konsultime me publikun gjatë dy viteve të fundit (2022-2024)?

- Planet strategjike (specifiko)
- Buxheti afatmesëm i bashkisë
- Buxheti vjetor i bashkisë
- Tarifat dhe taksat
- Projektet e investimeve
- Adminstrimin e aseteve dhe pronave
- Rregullore dhe plane veprimi
- Tjetër (Ju lutem specifikoni) _____

19. A e masni kënaqësinë e qytetarëve lidhur me mekanizmat që përdor Këshilli juaj?

Matshmëria	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Kënaqësia e qytetarëve	1	2	3	4	5

20. A keni patur ankesa nga qytetarët/grupe interesi lidhur me pjesmarrjen qytetare konsultimin publik?

Po Jo

21. Nëse po, si procedohet me ankesën?

22. Si njoftohen qytetarët lidhur me këtë çështje?

23. Sa ka qenë numri i ankesave në dy vitet e fundit? _____

24. A keni sistem monitorimi dhe vlerësimi të mekanizmave të përdorur?

Po Jo

25. Nëse po, jepni më shumë informacion mbi to (indiktorët që maten, kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin)?

26. A miratoni raporte vjetore të hartuara nga Këshilli Bashkiak për transparencën e proceseve vendim marrëse?

Po Jo

27. Si i vlerësoni kapacitetet e këshillit bashkiak për proceset e konsultimit ?

Perceptim	Shumë të aftë	Të aftë	Disi të aftë	Pak të aftë	Jo të aftë
Kapacitetet e këshillit bashkiak	1	2	3	4	5

28. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që ndeshni në angazhimin dhe konsultimin me publikun?

29. Çfarë nevojash do të kishit për të përmirësuar më tej këto procese?

30. Si vlerësoni situatën mbi zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

PYETËSORI PËR GRUPET E INTERESIT

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Pwrballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuar për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për grupin e interesit:

Emri _____

Organizatë _____

Biznes _____

Aktivist _____

1. Keni informacion se ju keni të drejta si person ose përfaqësues i palëve të interesuara për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon bashkia/këshilli bashkiak për vendim marrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit?

Po Jo

2. Cilat janë mjetet që jeni njoftuar për njoftimin dhe konsultimin publik? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Rregjistri elektronik	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambientet e bashkisë	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Lajmërim në mediat sociale (Facebook, iG etj)	1	2	3	4	5
Lajmërimi individuale	1	2	3	4	5
Botim në gazetën lokale	1	2	3	4	5
Tjetër, administratori, kryeplaku	1	2	3	4	5

3. Nëse po ju lutem specifikoni ku nga konsultimet e mëposhtme keni marrë pjesë ose keni kontribuar?

Format e pjesëmarrjes	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Dëgjesa për projekt buxhetin vendor 2023-2024	1	2	3	4	5
Dëgjesa për taksat dhe tarifën vendore	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshime në Planin e Përgjithshëm Vendor	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshimin e pronësisë së aseteve dhe pronave	1	2	3	4	5
Dëgjesa për programe të ndryshme	1	2	3	4	5
Dëgjesa për plane vendore dhe rregullore dhe	1	2	3	4	5
Botim në gazetën lokale	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

4. Nëse keni marrë pjesë, a keni dhënë rekomandime/propozime për Bashkinë ose Këshillin Bashkiak me shkrim ose elektronikisht te koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

5. A keni raste bashkëpunime bashkinë ose këshillin bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar ose për të organizuar takime publike në favor të grupit që ju përfaqësoni?

Po Jo

6. Nëse po, rekomandimet tuaja janë marrë parasysh?

Po Jo

7. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për çdo rast)

- Këshilli Bashkiak
- Staf i Bashkisë
- Organizata jofitimprurëse lokale
- Projekt i realizuar me donatorë
- Tjetër (specifiko) _____

8. Mendoni se rekomandimet tuaja janë marrë parasysh? A besoni se konsultimet publike sjellin ndryshime reale, apo bëhen vetëm për procedurë?

9. Në konsultimet publike të organizuara a ju kanë vënë në dispozicion materiale të projekt-aktit për ta shqyrtuar dhe për të dhënë rekomandime? (Nëse po, ju lutem siguroni një kopje të dokumentacionit për efekt studimi)

10. Nëse nuk keni qënë dakord me projekt-aktin dhe keni dhënë rekomandime, komente e vërejtje, a keni patur kohë në dispozicion për ti referuar dhe cila është rruga që keni ndjekur më poshtë?

- keni përgatitur kërkesë-ankesë dhe rekomandime për ndryshim
- keni mbledhur firma të qytetarëve dhe grupeve të interesit për ta kundërshtuar
 - jeni ankuar në institucione të tjera që kanë për detyrë monitorimin e punës së bashkisë dhe vendim marrjen e këshillit bashkiak.
- kemi komunikuar me mediat dhe grupet e interesit
- Nuk kemi gjetur një praktikë për t'u përshtatur në bashkinë tonë
- Tjetër

11. Në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik që ju keni marrë pjesë në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai ka? Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën, ju si palë të interesuara do të paraqesni ose dërgojnë rekomandimet tuaja? Po Jo

A u është treguar ose publikuar adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin? Po Jo

Sa kohe në dispozicion keni për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

12. Pse nuk marrin pjesë qytetarët në konsultimet publike? Jep opinionin tënd?

13. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët dhe grupet e interesit që ju përfaqësoni?

14. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

15. Nëse po/jo shpjegoni si:

16. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë anketim! Kontributi juaj është i vlefshëm për të kuptuar perceptimet publike mbi njoftimin dhe konsultimin publik në nivel vendor. Kjo anketë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Ai ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Kukës, Pukë, Vau Dejës) për të pasqyruar perceptimin e qytetarëve mbi njoftimin dhe konsultimin publik në këto njësi të qeverisjes vendore dhe impaktin në vendimarrje përmes konsultimit.

**Ju lutemi, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme me sinqeritet dhe duke u bazuar në aq njohuri sa keni. Nëse keni pyetje, ju lutem kontaktoni:
perballjaeofertavepolitike@gmail.com**

Seksioni A: Konsultimi Publik

A1. Bashkia:

This is a question help text.

- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Korçë
- Kukës
- Pukë
- Shkodër
- Tiranë
- Vau i Dejës
- Vlorë

A2. 2. Gjinia:

- Femër
- Mashkull

**A3. 3. Moshë:**15-29 vjeç 30-45 vjeç 46-65 vjeç Mbi 65 vjeç **A4. 4. Zona e banimit:**Zonë Urbane Zonë Rurale **A5. 5. Keni informacion për ligjin për konsultimin publik në Shqipëri, ku procesi i njoftimit dhe konsultimit publik me qytetarët, para marrjes së vendimeve duhet të organizohet nga bashkia dhe këshilli bashkiak?**Po Jo **A6. 6. A keni marrë pjesë në dëgjuesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak në dy vitet e fundit?**Po Jo **A7. 7. Nëse JO, përse nuk keni qënë pjesë e konsultimeve?**Nuk e di që kam të drejtë të komentoj, të bëj vërejtje dhe ndryshime në vendimet që merr bashkia dhe/ose këshilli bashkiak. Nuk jam i/e informuar, nuk kam njoftim se kur mbahen konsultimet publike Nuk më intereson Nuk marr pjesë sepse mendimet e mia nuk merren parasysh Tjeter

Tjeter

A8. 8. Nëse PO, specifikoni si jeni vënë në dijeni të procesit?Njoftime nga rregjistri elektronik/faqe web e bashkisë Nëpërmjet postës elektronike (e-mail) Lajmërim i publik afishuar në ambientet e bashkisë Lajmërim në mediat audio-vizive lokale Lajmërim në mediat sociale (Facebook, Instagram, X, etj)



Lajmërimi individuale

Tjetër (administratori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar)

A9. 9. A janë marrë në konsideratë vërejtjet/sugjerimet/komentet tuaja?

Po

Jo

Nuk e di

Pjesërisht

A10. 10. A jeni ankuar ndonjëherë në lidhje me ndonjë aspekt të procesit të konsultimit publik?

Jo, nuk jam ankuar

Po jam ankuar por nuk kam marrë përgjigje

Po jam ankuar dhe kam marrë përgjigje

A11. 11. A keni besim se përmirësohet vendimarrja, në dobi të qytetarëve nëse zbatohen me përpikmëri procedurat e konsultimit publik?

Po

Jo

A12. 12. Në vlerësimet e mëposhtme cilat mendoni se janë probleme të konsultimit publik?

Nuk njoftohemi në kohë në lidhje me një draft vendim që hidhet për konsultim

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak bëjnë konsultim publik formal

Bashkia dhe Këshilli bashkiak nuk e bëjnë konsultimin publik me grupet e dhura të qytetarëve dhe të interesit

Grupet e interesit dhe qytetarët nuk kanë mundësi për të shprehur mendimet e tyre alternative pro ose kunder në lidhje me projekt akte gjatë procesit të konsultimit publik.

Edhe kur njoftohem për konsultimet publike ka pak mundësi të diskutojnë të gjithë, mungojnë materialet shoqëruese dhe nuk përcaktohen afate që pas takimeve të paraqiten vërejtjet ose argumentet e qytetarëve.

Bashkia ose Këshillit Bashkiak nuk i marrin parasysh rekomandimet e dhëna nga qytetarët dhe grupet e interesit gjatë procesit të konsultimit.

Nuk ka interes nga vetë qytetarët të marrin pjesë, nuk duan të përfshihen.

Faleminderit! Rrjeti POP

RRJETI POP

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."

KONTAKT

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1,
Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 422255514

Mobile: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>